

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 220, Shkurt 2022
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

DITA BOTËRORE E PAQES - 10 janar 2022

Pavarësisht gjendjes së vështirë, për shkak të pandemisë Covid-19, në Shqipëri por dhe në botë, tradita më se 20 vjeçare e celebrimit të ditës botërore të paqes, nuk do të mungonte as për vitin 2022. Kështu që, Arqipeshkvia Shkodër-Pult nëpërmjet Komisionit Drejtësi dhe Paqe të Shqipërisë, me 10 janar, në teatrin "Migjeni" do të organizonte koncertin festiv, me temë "Viti i Mbarë o Shkodër".

I bazuar në mesazhin e Shenjtërisë së Tij, Papa Françeskut, me titull "Dialogu mes brezave, edukimi dhe puna: mjete për ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme", mesazh ky i drejtuar drejtuar mbarë botës.

Gjatë zhvillimit të koncertit, përveç anës artistike, vend të veçantë do të zinte edhe leximi nga pjesë të mesazhit të Atit të Shenjtë, i cili, në këto kohë të vështira, në të cilat po jetojmë, ku të pasurit po pasurohen gjithnjë e më shumë dhe të varfrit po varfërohen deri në skamje, bën thirrje për ndihmë ndaj të varfërave më të varfëra të shoqërisë.



SHOSHI KUJTON E KËNDON

"Shoshi kujton dhe këndon", është titulli i Manifestimit-2022 i Shoqërisë kulturore artistike "Besa Shosh", që realizoj për herë të parë në bashkëpunim me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" dhe TV1 Chennal, me datën 23 dhjetor 2022, në ambientet e lokalit "Rinia", në Bardhaj. Me rastin e festave të fund vitit 2021, grupi "Besa Shosh" mendoj të realizonim një program artistik me pjesë muzikore letraro-historike nga Shoshi dhe Dukagjini. Ky manifestim ishte produkt i grupit "Besa-Shosh", në bashkëpunim me krijues, studiues, historian dhe intelektual të Shoshit dhe Dukagjinit, për ngjarje historike të Shoshit nder shekuj. Viti 2021 ishte: 290 vjetori i djegies së Shoshit nga Begollet e Pejës, pasi në vitin 1731 Shoshi u dogj me gjithë çka pat. Banoret e Shoshit u strehuan në Komlem të Gurit të Lekes, për ti shpëtuar sulmit barbar të tabançurke.

*260 vjetori i djegies së Ipushkvis në Gurrë të Shoshit ...



DARKA E DUKAGJINIT NË NEW JORK

Trashëgimia kulturore e Dukagjinit po pasurohet nga viti në vit me krijimet dhe interpretimet e reja të paraqitura në veprimtaritë e ndryshme të zhvilluara kudo ku ka shqiptar e në veçanti ku ka dukagjinas. Më të dendura këto veprimtari zhvillohen në çdo, fund viti duke e pasuruar në sasi e cilësi trashëgiminë kulturore - artistike të Dukagjinit. Kështu ndodhi edhe në fund të vitit që sapo mbyllëm. Nuk ka rëndësi se si emërtohen këto veprimtari: darka, nata, treveza apo ndonjë emërtesë tjetër, por rëndësi ka se sa vlera folklorike e artistike paraqesin. Në shumicën e këtyre veprimtarive dominojnë krijimet e reja sidomos të kantautorit të mirënjohur Fran Kodra. Është për t'u përgëzuar dhe entuziazmuar, sepse kudo ku ka dukagjinas, edhe pse të larguar nga vendlindja, mbartin me vete atdhedashurinë, vetitë dhe virtytet më të mira të trashëguara, që i qëndrojnë kohës dhe bëjnë përpjekje për të mbajtur gjallë vlerat më të mira kulturore dhe artistike, duke i pasuruar ato nga viti në vit, ku në këtë aspekt shquhen dukagjinat me banim në SHBA.

Libri i Sospellos 1652

Relatione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Minori Osservanti Riformati del serafico P're S. Francesco nel Regno d'Albania, të autorit P. fra Giacinto da Sospello

HYRJE! Libri, që po ju paraqesim është një dorëshkrim i pjesës së parë të shekullit XVII. Sipas shënimeve në krye të shumicës së faqeve të tij dhe disa datave të shënuara në vende të veçanta besojmë se materiali që përfshihet në të duhet të ketë filluar të shkruhet në vitin 1634 dhe duhet të ketë përfunduar në vitin 1650. Është i ruajtur në Bibliotekën e Bashkisë së qytetit të Feros në Itali të quajtur Biblioteca Civica "Romolo Spezioli" me skedën 4-E-7, n. 58, sec. XVII ndjekur nga titulli "GIACINTO P. Da Sospello - Relatione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica..."

DITA BOTËRORE E PAQES - 10 janar 2022

Pavarësisht gjendjes së vështirë, për shkak të pandemisë Covid-19, në Shqipëri por dhe në botë, tradita më se 20 vjeçare e celebrimit të ditës botërore të paqes, nuk do të mungonte as për vitin 2022. Kështu që, Arqipeshkvia Shkodër-Pult nëpërmjet Komisionit Drejtësi dhe Paqe të Shqipërisë, me 10 janar, në teatrin "Migjeni" do të organizonte koncertin festiv, me teme "Vit të Mbarë o Shkodër".

I bazuar në mesazhin e Shenjtërisë së Tij, Papa Françeskut, me titull "Dialogu mes brezave, edukimi dhe puna: mjete për ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme", mesazh ky i drejtuar drejtuar mbarë botës.

Gjatë zhvillimit të koncertit, përveç anës artistike, vend të veçantë do të zinte edhe leximi nga pjesë të mesazhit të Atit të Shenjtë, i cili, në këto kohë të vështira, në të cilat po jetojmë, ku të pasurit po pasurohen gjithnjë e më shumë dhe të varfrit po varfërohen deri në skamje, bën thirrje për ndihmë ndaj shtresave më të varfëra të shoqërisë.

Koncerti nuk do të ishte i plotë pa praninë e shumë të rinjve të qytetit, të cilët me talentet e tyre e mbajnë publikun të karrikuar emocionalisht gjatë gjithë kohës. Shumë këngëtarë, valltarë dhe poetë do të interpretonin në skenë duke marrë si shpërblim duartrokitjet e gjata të publikut shkodran. E veçanta e këtij viti ishte edhe prania e dy shoqatave, të cilat kujdesen për personat me aftësi të kufizuara dhe pikërisht, "The Door Albania" dhe "Projekti Shpresa", kjo e fundit nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Imzot Angelo Massafra.

Banda muzikore e "The Door", të shoqëruar edhe nga këngëtarët e talentuar Megi Toma dhe Savina Kurti, do të interpretonin dy këngë ndërsa "Projekti Shpresa", nën drejtimin e znj. Suela Ndo-



ja, psikologe pranë kësaj qendre, do të interpretonin një pantomimë, e cila kishte

në thelb të saj bashkëpunimin në shoqëri. Në këtë mbrëmje do të ishin të pra-

nishme autoritete lokale të Shkodrës, ku mund të përmendim zj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër; z. Hilmi Lakti, Kryetar i Qarkut Shkodër; anëtarë të këshillave lokale e të tjerë.

Rëndësi të veçantë kishte dhe prania e besimeve të tjera fetare në Shqipëri, ku binte në sy prania e përfaqësuesve nga besimi mysliman si dhe përfaqësues nga besimi bektashi.

Gjithashtu ishin të pranishëm edhe shumë intelektuale, qytetarë të thjeshtë të qytetit, Kongregata katolike si dhe shumë të rinjë.


Kjo mbrëmje festive do të karakterizohet edhe nga një tjetër ngjarje, 25 vjetorin e shugurimit ipeshkvnor të Imzot Angelo Massafra. Kjo ngjarje do të zinte pjesën e saj në këtë mbrëmje artistike, gjatë së cilës do të shfaqej një dokumentar i shkurtër, gjatë së cilit do të përmendeshin disa nga kontributet e tij më të rëndësishme si në aspektin shoqëror ashtu edhe në atë fetar, që nga moment i ardhjes së tij në Shqipëri dhe deri në ditët e sotme.

Gjithashtu në shenjë falënderimi për kontributin e tij si Arqipeshkëv i Shkodër-Pult për të gjithë qytetarët e Shkodrës, Këshilli i Qarkut Shkodër do ti akordonte Imzot Massafres titullin "Qytetar Nderi i Qarkut", titull i cili do ti dorëzohet po atë mbrëmje nga kryetari i këtij qarku z. Hilmi Lakti.

Veprimtaria u përmbyll me urimin për banorët e Shkodrës për një vit të mbarë dhe me shpërndarjen për të pranishmit të mesazhit të Atit të Shenjtë, të përkthyer dhe botuar nga Arqipeshkvia Shkodër – Pult.

Majko Mila

Genet "kriminale" dhe mjedisi



Sapo vdiq babai i mafies botërore, Don Vito Corleone, njerëzit e klanit të mafias, menjëherë i puthën dorën djalit të tij, Michael Corleone, duke e pranuar pa asnjë mëdyshje si udhëheqës të tyre. Nëse ai ishte po aq i aftë për të drejtuar mafien sa dhe i ati, ndoshta nuk e dinte klani i mafias, por e menduan të tillë dhe i dhanë besimin. Të thuash se e menduan të tillë, nuk duhet menduar se mafia i mendon gjërat ashtu thjeshtë, pa u bazuar diku.

Babë e bir, për arsye të ndryshme dhe

në rrethana të padëshirueshme, ishin ndarë herët me njëri-tjetrin. Pas disa vitesh, ashtu si rastësisht, takohen përsëri bashkë. Takimi ndodh në një vend aspak të këndshëm, në njërin nga burgjet e Arizonës në Amerikë. Të dy ishin dënuar me vdekje për vrasje me paramendim. Djali ishte gjenerata e tretë që denohej me vdekje, për vrasje me paramendim. Të dy kishin dhe një pasion të përbashkët, lojën e shahut. Gjatë kohës që ata prisnin ekzekutimin e vendimit me vdekje, luain shah me njëri-tjetrin. Por jo përballë njëri-tjetrit në tavolinë. Rregulli i dënimit me vdekje nuk i lejonte të bashkëjetonin në një dhomë. Lëvizjet në kutinë e shahut i mësonin nëpërmjet rojeve të burgut.

Në kohën e diktaturës kam njohur katër vëllezër, diku nga veriu i vendit, të cilët ishin dënuar për krim kundër personit. Tre nga ata ishin dhe përsëritës për të njëjtin krim. Babai i tyre, në moshën 34 vjeç, ishte dënuar me vdekje për vrasje. Një nga vëllezërit e tyre e kishte humbur jetën në një dyluftim. Në krahasim me të dënuarit e tjerë, e mbanin veten të moralshëm,

me idenë se, jemi dënuar për trimëri.

Në verën e vitit 2012, diku nga Shqipëria e mesme, babë e bir, të armatosur, rrethojnë një familje "armike", thërrasin të zotin e shtëpisë dhe, që të dy njëherësh, e sulmojnë me thika duke e lënë të vdekur.

Në shembujt e më sipër, fare thjeshtë mund të mendohet se njerëz të tillë, diku brenda tyre, kanë të fshehur genin kriminal të trashëguar, i cili i detyron ata që të kryejnë vepra kriminale kundër shëndetit dhe jetës së të tjerëve.

Vrasësi me paramendim (për gjakmarrje dhe hakmarrje), nuk është kurrë rastësi. Brënda tij, dremitë geni kriminal, ai i vrasjes i cili, zgjohet në momente të caktuara. Ai është vrasës dhe, nëse i jepet mundësia, vret përseri.

Krimineli gjithmonë planizon aktin e krimit, me shumë kujdes, deri në detaje dhe, e kryen me gjakftohtësi. Planizimi i gjakmarrjes dhe, i hakmarrjes me jetën e tjetrit, është shkalla më e lartë e ligësisë dhe barbarizmit të njeriut mbi njeriun. Është i pakuptimtë dënimi alternativ për gjakmarrësit dhe hakmarrësit, me jetën e

njeriut. Vetëm një drejtësi e korruptuar, pjesë e një tip shteti terrorist, jep dënime alternative në raste të tilla.

Hulumtimet shkencore, kryesisht me binjakë, një dhe dy vezor, mendohet se po sjellin të reja mbi ekzistencën dhe pushtetin e genit kriminel tek njeriu. Nga eksperimentet e kryera me vëllezër binjakë mendohet se trashëgimia genetike luan një rrol shumë të rëndësishëm në perversitetin, dhunën dhe krimin tek njeriu. Binjakët njëvezor janë qind për qind të ngjashëm ndërsa ata dyvezor pesëdhjetë për qind. Ajo që ju tërheq shumë vëmendjen studiuësve të rolit të trashëgimisë gjenetike është fakti se si është e mundur që binjakë, të rritur në të njëjtën familje dhe në të njëjta kushte sociale, formojnë personalitete kaq të ndryshme nga njëri-tjetri? Madje edhe njëvezorët. Konkluzioni është se, ky ndryshim, është pasojë e genit brënda secilit.

Një studio gjenetike daneze bëri të njohur një rezultat interesant. 80 për qind e personave që kryejnë krime kundër personit, janë nga familje të dhunshme, 76 për qind e përsëritësve në krim ndaj pronës dhe 50 për qind e krimeve ndaj personit janë rrjedhojë e trashëgimisë genetike. Ky përfundim u mendua një zbulim interesant për rolin e gjenetikës në fushën e kriminalitetit. (vijon në faqen 5)

MANUEL VESCOVI SENATOR I PARLAMENTIT ITALIAN, MIK I MIRËPRITUR I SHOQËRISË “BESA-SHOSH”

Kush është Manuel Vescovi?!

Manuel Vescovi senator i parlamentit Italian e Zv. President i delegacionit italian në Këshillin e Evropës, ka lindur në Padova, me 30 maji të vitit 1970, gjenealogjikisht është toskan. I diplomuar për Drejtësi në Universitetin e Bolonjës, nga viti 1990 deri në vitin 1998 ka qenë agjent i zgjedhur i Policisë së Shtetit. Politikan profesionist i rafinuar dhe inteligjent, orator i zhërvjellët i shkathet, simpatik i qeshur, sy mprehtë, njohës dhe mik i mirë Shqipërisë

Që nga viti 1991 është i apasionuar pas rrugës politike të lëvizjes Lega Nord në Veneto, duke mbuluar edhe rolin e sekretarit të lëvizjes rinore të provincës së Padovës.

Manuel Vescovi ka qenë i interesuar për lëvizjen e Ligës së Veriut në Toskanë që nga viti 2006, ndërsa në vitin 2010 u zgjodh Shef i Stërvitjes për Militantët e Shkollës së Kuadrit. Në vitin 2011 u zgjodh sekretar provincial i Pistoias. Më 21 Prill 2013 u zgjodh Sekretar Rajonal i Lidhjes në Toskanë. Gjatë Kongresit nis një projekt të quajtur “Toscana 2020” ku tregon qëllimin e fitimit të Rajonit në 2020 dhe të gjitha hapat e ndërmjetëm duke përfshirë zgjedhjen e të paktën një Këshilltarit Rajonal në 2015, të të paktën një kryebashkiak të Ligës së Veriut. Në vitet në vijim liga zgjedh gjashtë këshilltarë rajonalë në zgjedhjet e 2015-ës, qendra e djathtë merr kryetarin e bashkisë në gjashtë kryeqytete provinciale (Arezzo në 2015, Grosseto në 2016, Pistoia në 2017, Massa, Pisa dhe Siena në 2018), dhe Susanna Ceccardi u zgjodh kryebashkiaku i parë i Ligës Veriore në Cascina. Lidhja bëhet partia e dytë më e madhe në rajon, duke përfunduar me zgjedhjen e nëntë parlamentarëve në Toskanë në vitin 2018.

Më 31 maj 2015 ai bëhet këshilltar rajonal i Toskanës i Ligës Veriore të së cilës është drejtues grupi dhe anëtar i komisionit të tretë. Zëdhënës i opozitës nga data 4 shkurt 2018 deri më 27 mars 2018. Ka mbajtur detyrën e këshilltarit të qarkut deri më 10 prill 2018.

Në vitin 2019 ai u zgjodh Këshilltar Bashkiak në komunën e Cinigiano, në provincën e Grosseto, duke rezultuar që kandidati të kishte marrë më së shumti preferenca.

Në zgjedhjet politike më 23 mars 2018 në legjislaturën XVIII të Republikës Italiane në grupin parlamentar të qarkut Lega Nord - Salvini të Toskanës. Sekretar i Komisionit të 3-të të Përhershëm (Punët e Jashtme, Emigracioni)

Që nga 21 qershor 2018, Vescovi zgjidhet nga Senati si delegat në Këshillin e Evropës dhe Zëvendës President i delegacionit italian në Këshillin e Evropës. Prej shkurtit 2019 ka qenë edhe kryetar i seksioneve të miqësisë dypalëshe për Shqipërinë, të krijuar në kuadër të Unionit Ndërparlamentar (UIP).

MBRESA NGA NJË DITË E PAHARRUAR

Një personalitet me karrierë inkandeshentë, lundërtar i regjur mes baticave dhe zbatave të politikës italiane, por dhe

mikun më të veçantë, që ka bujtur në konakun e saj deri më sot. Senatori latin Manuel Vescovi erdhi i shoqëruar nga Zj. Monica Micheli Panozzo, një biondinë hirplote elegante, e çiltër si vera në gastare dhe shumëdashamire. Fliste

sonim, por edhe të prezantohemi se kush jemi dhe çfarë përfaqësojmë. Na dëgjuan me vëmendje, shprehën interes, mësuan histori e traditë shqiptare, u gëzuan dhe ndjemë lirshmëri sikur njiheshim prej vitesh. Bisedat qenë spontane, pa protokoll a leksik të rafinuar politiko-diplomatik. Senatori e dinte dhe e përforcoi më tepër mendimin, për lidhjet dhe simpatitë ndërshekullore mes dy vendeve. Vetëm kur iu kujtua periudha e okupimit në Luftën e Dytë, ju ndërpre pakëz buzëqeshja gjë që nuk e bënte të ndihet mirë. Ai e donte Shqipërinë të emancipuar dhe pjesë të Evropës. Kam qenë dhe jam lobues që ju të jeni pjesë e Bashkimit Evropian. Do doja të ishit që tani dhe të mos zgjasë më gjatë pritja juaj e shumëdashuruar. Futuni në Evropë por “Evropën” mos e bëni kryefjalë monetare. Jeni të vegjël dhe do u shkaktojë dhimbje te reja. Nderimi i shpeshtë i qeverive italiane ka ndikuar negativisht në transferimin e investimeve madhore në infrastrukturën dhe ekonominë shqiptare.

Duke qenë fotografues i mirë i pro amerikanizmit pa limit, dhe nostalgjive ndaj ish perandorive apo fuqive në ngjitje në ringun botëror Z. Vescovi syzoi indirekt se Shqipëria ka nevojë më shumë për politika partneriteti ndaj fqinjëve se, për dashuri vasale ndaj superfuqive.

Dikur, kur vinte një mik dhe te gjente njerëzit shtruar në trevezë thuhej:

-Mirë se erdhe, sa fort po të dashka krushka! Kështu i ngjau edhe Zotit Sali Berisha, që erdhi për kafe tek “Tradita” e Gjon Dukgëlës dhe na gjeti më lugë në “bludë”. Nga sa kuptova personi që e donte më shumë se askush nga ne Berishën (engjell e djalle) ishte senatori Z. Vescovi. Ustallarët e vjetër të mangallave, politike, pinë një kafe dhe shkëmbyen biseda të karakterit kulturor. Si mjeshtër i komunikimit publik Berisha i dhuroi një buqetë lavdërimesh, të karakterit historik dhe kulturor edhe Dukagjinit. Nuk e dija, as nuk e prisja Berishën atë ditë tek “Tradita”, por as nuk më shkoi në mendje t’i shmangesha për shkak të statusit, dhe nuk hezitova që t’i dhuroj librin e vetëm që kisha me vete “Dukagjini ynë” IV (Klerikët martirë).

Miku italian u prononcua në disa media vizive si TV1 Chennel, Syri e të tjera. Moderatorja e talentuar Linda Kavaja vuri qershinë mbi tortë me specialën që për emisionin Start ku të pranishëm qenë miqtë e mirë së ardhur italian. Leonora regjistroi në celuloid një kolazh fotosh që do të jenë një panoramë përkujtimore në historikun e Shoqërisë “Besa”

Aktiviteti u mbyll me një ftesë për Shoqatën “Besa” për Festivalin ndërkulturor “ALBANITALY”, me 12 qershor 2022, që do zhvillohet Firenze.

Prele Milani



Nga e majta ne te djathte Gjon Kosteri, Prele Milani, Manuel Vescovi, Leonora Milani, Anton Kosteri, Monica Micheli Panozzo dhe Ndoc Fusha (Kryetari i Shoqatës kulturore “Besa Shoshi”)

ekspert i niveleve më të larta në Këshillin e Evropës, Manuel Vescovi, kur flitej për Shqipërinë, kulturën dhe marrëdhëniet shqiptaro-italiane, dëgjonte me shumë vëmendje, fliste me pasion deri në detaje, demonstronte respekt, thjeshtësi dhe rrezatonte dashuri dhe mirësi

Të kesh mik në tryezën tënde një personalitet të tillë internacional si Manuel Vescovi është nderë dhe vlerësim për çdo nivel pushteti, institucion politik, legjislativ apo kulturor të këtij vendi të vogël, i cili e donte dhe e vlerësonte pa syze paragjykuese.

Një përfaqësi nga Shoqëria Kulturore Besa (Ndoc Fusha, Gjon Kosteri, Anila Milani, Gjon Dukgëlaj, Anton Kosteri, Leonora Milani dhe Prele Milani (me datën 13 shkurt 2022, në Bar Restorant “Tradita”, priti me bujari tipike shqiptare

pak shqip, por kuptonte gjithçka, shumë e gatshme për mbarëvajtjen dhe pasqyrimin e aktivitetit në çdo aspekt. Shkuesi i kësaj miqësie të re, që hodhi shtat mes nesh ishte Zoti Gjergj Temeli, anëtar themelues i Shoqërisë “Besa” dhe njëkohësisht Kryetari i Shoqatës Bashkësia Shqiptare me qendër në Firenze. Zoti Temeli për arsye familjare nuk mundi t’i shoqëronte, por ai ishte i pranishëm me respektin, konsideratën dhe dashurinë që kishin miqtë përtej detit e që shprehën për mikun tonë të vjetër. Vizitën e Z. Vescovi dhe Zj Monica e pritëm me respekt, emocion dhe përgjegjësi, që të prezantohemi ashtu siç jemi, pa ndjenjë inferioriteti siç u ndodhë zakonisht shqiptarëve me të huajt, dhe pa komplekse folklorike të një lashtësie mostre me planetin. E dëgjua me dëshirë e mire që të më-



Gjon Kosteri e Manuel Vecovi e Manuel Vescovi

ZËRI I BUJAR QAMILIT NDERON KOMBIN

Këngëtari i madh Bujar Qamili vlerësohet me titullin e Lartë “Nderi i Kombit”

*K'ndo Bujar me t'bukrin za,
Se largohen ret' nga qielli,
Thot bilbili nuk k'ndoj ma,
Ma kalon Bujar Qamili.*

Këto vargje i shkëputa nga strofa e një kënge, tekstin e së cilës e kam shkruar disa vite më parë kushtuar këngëtarit të madh Bujar Qamili. Sa herë zë pendën me dorë dhe vendosi të shkruaj për të madhin e të mëdhenjëve, për zëmbëllin, bilbilin e Shkodrës, këngëtarin Bujar Qamili, asnjëherë nuk ndjehem i plotësuar në atë çfarë dua të paraqes për lexuesit kur është publicistikë, por veçanërisht kur thur vargje kushtuar zërit të tij, këngës së tij, artit të tij. Për mua është një sfidë më vete duke ditur pritshmëritë e artëdashësve të tij, nivelin e këngëve që tashmë janë një album me vlerë, ku shpërthen aroma e këngës së bukur qytetare shkodrane. Janë të shumta shkrimet dhe tekstet e dedikuara këtij kollosi bashkëkohor me të cilin mburremi, krenohemi dhe vlerësohemi si qyteti i djepit të kulturës dhe sërish e ndjej se nuk është thënë sa duhet.

Të njëjtat gjëra po diskutonim me një grup miqsh të Bujarit edhe gjatë udhëtimit tonë nga Shkodra për në Tiranë, ku na dukej vetja si dasmorë të motivuar nga entuziazmi i kësaj dite të shënuar për Bujarin aq sa, pothuajse askujt nuk i ra në sy fakti, se gjatë gjithë rrugës na shoqëroi një mot me shi të dendur.

Me të mbërritur në Pallatin e Brigadave, ku Presidenti i Republikës z. Ilir Meta kishte përgaditur një pritje ekselente enkas për të, entuziazmi arriti kulmin, aq sa Ai të recitonte vargjet e një kënge kushtuar Bujarit. Në të vërtetë kjo është edhe një nga arsytet që më ka motivuar për të shkruar edhe për këtë rast, ndaj me plot të drejtë mund të them se me këtë vlerësim të akorduar nga z. Ilir Meta, Bujar Qamili ka prekur majat e sukseseve të tij.

Sot Bujar Qamili, bilbili i djepit të kulturës u vlerësua me titullin më të lartë “Nderi i Kombit” dhe vetë Presidenti i Republikës, gjatë një ceremonie madhështore të organizuar në Pallatin e Brigadave, u shpreh me fjalët: “Nuk besoj të ketë shqiptar në çdo trevë ku flitet dhe këndohet shqip, që të mos ketë dëgjuar dhe kënduar të paktën një këngë të artistit të madh dhe shumë të dashur, Bujar Qamili. Për mbi katër dekada në skenë, me zërin magjik dhe interpretimin e jashtëzakonshëm, ai është kthyer në simbolin e këngës popullore shkodrane dhe shqiptare, duke fituar zemrat dhe duartrokitjet e zjarra të publikut, për t'u bërë me repertorin e tij të magjishëm, pjesë e gëzimeve në familjet dhe vatrën shqiptare. Në vlerësim të kontributit të vyer dhe të rëndësishëm, në ruajtjen, kultivimin dhe përhapjen e këngëve popullore, duke e shtuar dashurinë dhe krenarinë për vlerat e jashtëzakonshme kombëtare dhe kulturore, e çmova sot Bujar Qamilin me

Dekoratën e lartë “Nderi i Kombit”.

“Nuk k'ndoj ma thotë bilbili,
Ma kalon Bujar Qamili.”

Dhe me të vërtetë do ta quajmë një vlerësim mëse të merituar, këtë nderim që i bëhet në emër të Kombit, pasi këngëtari i madh Bujar Qamili për një gjysëm shekulli ka dhënë një kontribut tepër të çmuar në ruajtjen dhe kultivimin e këngës po-

kombe e kultura të tjera.

Bujar Qamili është një këngëtar i freskët dhe tepër i dashur, i cili që në moshë të re i këndoi popullit të vet, i këndoi qytetit të tij, i këndoi dashurisë dhe rinisë. Ai, që fare i ri, që në debutimet e para, arriti të fitojë dashurinë dhe admirimin e publikut shkodran dhe mbarë artëdashësve shqiptarë. Me zërin e tij brilant



pullore shqiptare e në veçanti asaj shkodrane. Ai është një ndër këngëtarët më të mëdhenj të shekullit, i cili me zërin e tij ka arritur të bëjë për vete Kombin Shqiptar. Falë dhuntisë, punës, pasionit dhe përkushtimit ndaj këngës ndër vite, ka akumuluar në karrierën e tij një mori vlerësimesh e çmimesh të fituara si interpretues i këngës popullore, duke e sjellë atë para publikut jo vetëm me një repertor

arriti ta lartësojë këngën popullore, këtë trashëgimi të kulturës shqiptare, në skajet më të largëta në të pesë kontinentet e botës ku ka shqiptarë.

Bujar Qamili është fitues i shumë çmimeve dhe trofeve në konkurse e veprimtari kulturore e artistike. Ai është përfaqësues i Shqipërisë në disa Festivale Ndërkombëtare dhe pjesëmarrës në shumë koncerte në Radio Televizionin



shumë të pasur, por edhe me një performancë brilante.

Ai, në jetën e tij artistike e sociale është ndër të rrallët artistë që është vlerësuar si misionar i paqes për interpretimin dhe kultivimin e artit muzikor shqiptar, duke e bërë atë urë komunikimi jo vetëm në hapësirën shqipfolëse, por edhe me

Shqiptar. Bujar Qamili gjatë karrierës së tij artistike ka realizuar shtatë koncerte recitale në Tiranë e në Shkodër, ku sallat e mbushura plot kanë dhënë vlerësimin e tyre me ovacione e duartrokitje të pafund.

Ai ka organizuar disa koncerte bamirësie brenda dhe jashtë vendit për njerëzit në nevojë, aty ku arti shëron,

lumturon dhe jep jetë, si në Shtëpinë e Fëmijës e në Shtëpinë e të Moshuarëve, për të ardhur tek disa koncerte madhështore gjatë periudhës së pandemisë në mes të qytetit, ku triumfoi me koncertin madhështor “Dhuratë për Shkodren”, një sfidë ndaj së keqes që kërcënonte njerëzimin, por edhe një zë shprese e optimizmi për ta mposhtur atë. Ai u ndoq nga qindra qytetarë të të gjitha moshave që e duartrokitnin nga dritaret e ballkonet e pallateve, që këndonin bashkë me të dhe që i tregonin atij se e donin dhe e vlerësonin pikërisht se ai, me këngët e tij, me këngët e qytetit të tyre, ua bënte më të lehtë situatën që ishte krijuar duke i motivuar që ta kalonin sa më lehtë.

Ky këngëtar i madh shquhet edhe për bashkëpunime e kontribut të lartë në evidentimin dhe inkurajimin e zërave të rinj, e talenteve që Shkodrës nuk i kanë munguar kurrë, duke bërë që kënga e bukur popullore të jetojë e të lulëzojë brez pas brezi.

Bujar Qamili është padyshim një gurrë e pashtrësme me fondin e tij të pasur muzikor edhe në lëmin etnokulturor. Ai është një thesar me vlera të vyera kombëtare, me të cilat shqiptarët ruajnë dhe trashëgojnë gjuhën, muzikën dhe dashurinë për Kombin.

Ndihem me shumë fat që në repertorin e tij spikasim një mori këngësh mjaft të vlerësuar të bashkëpunimit tonë, por mbi të gjitha për faktin se këngëtari Bujar Qamili është edhe miku im më i afërt.

Përtej karrierës artistike ai mbetet një qytetar model, njeri dinjitoz dhe artist mjaft i dashur, çka e dëshmoi edhe gjatë tryezës së shtruar me këtë rast në lokalitetin “Kaon” në Tiranë me pjesëmarrjen e familjes dhe miqve të tij të shumtë: Agron Çela, Edmond Ndou, Zija Vukaj, Engjell Ndocaj, Ben Tafili, Ramazan Çeka, Jetmir Barbullushi, Bardhyl Hysa, Gazmend Kraja, Mukades Çanga, Adnan Bala, Mateus Frroku, Shkëlqim Hajdari, Dritan Ylli, Gani Muçmeraj, Skender Kaziu, Jahir e Ilmije Hasani, Dule Malindi, Klinsman Llazani e shumë të tjerë dhe ku pjesëmarrja e Presidentit të Republikës z. Ilir Meta ishte qershia mbi tortë e gëzimit të Bujar Qamilit dhe ku me modestinë e tij brilante tregoi edhe njëherë se ai, këngëtari Bujar Qamili, “Mjeshtër i Madh” i Këngës dhe “Nderi i Kombit” për kontributin e pasqor, mbetet po i njëjti shkodran karizmatik, bujar dhe dashamirës ndaj kolegëve, miqve dhe artëdashësve të shumtë që vërshuan me telefonata dhe mesazhe për ta uruar në këtë ditë të shënuar.

Në emër të të gjithë artëdashësve shqiptarë, anë e mbanë botës, qytetarëve të Shkodrës dhe miqve tanë të përbashkët gjej rastin t'i uroj nga zemra e mbash me shëndet e me suksese të mëtejshme titullin e lartë “Nderi i Kombit”.

**Nga Ramazan Çeka,
Shkurt 2022**

SHOSHI KUJTON E KËNDON

“Shoshi kujton dhe këndon”, është titulli i Manifestimit-2022 i Shoqërisë kulturore artistike “Besa Shosh”, që realizoj për herë të parë në bashkëpunim me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” dhe TVI Chennai, me datën 23 dhjetor 2022, në ambientet e lokalit “Rinia”, në Bardhaj. Me rastin e festave të fund vitit 2021, grupi “Besa Shosh” mendoj të realizonim një program artistik me pjesë muzikore letraro-historike nga Shoshi dhe Dukagjini.

Ky manifestim ishte produkt i grupit “Besa-Shosh”, në bashkëpunim me krijues, studiues, historian dhe intelektual të Shoshit dhe Dukagjinit, për ngjarje historike të Shoshit nder shekuj.

Viti 2021 ishte:

*290 vjetori i djegies së Shoshit nga Begollet e Pejës, pasi në vitin 1731 Shoshi u dogj me gjithë çka pat. Banoret e asaj kohe u strehuan në Komlem të Gurit të Lekes, për ti shpëtuar sulmit barbar të taborëve turke.

*260 vjetori i djegies së Ipeshkvis në Gurrë të Shoshit ose ndryshe kisha e Shnreut.

*215 vjetori i vrasjes së Marash Tucit të Brashtes, në Shkodër nga turqit, pasi ky ishte ndore e parisë së Nikajve dhe i vranë miqtë dhe mbeti edhe vet, për miq, duke vra Ibrahim pashën

*80 vjetori i luftës së Gurit Kuq në Lbriqe të Shoshit, ku u thyen dhe u shpartalluan Serbet, kur kishin varros edhe njerëz të gjallë në Shosh.

Ishin këto ngjarje dhe të tjera ngjarje, që na motivuan për të organizua një veprimtari të tillë, me udhëheqës organizativ Ndoc Fusha, kryetari i Shoqatës “Besa Shoshi” dhe pronari i lokalit “Rinia”; me libret nga studiuesi, poeti, botuesi e publicisti Prele Milani, me udhëheqës artistik rapsodi Gjon Kosteri. Në këtë veprimtari ishin të ftuar mjaft këngëtar, në mes tyre Ansambli “Rugova”, me kryetar valltarin e këngëtarin popullor Vasel Nikçi dhe gru-

pi artistik i shkollës 9-vjeçare “Ded Gjon Luli”, në Hot të Ri nën drejtimin e mësueses Drita Zefi, bijë nga Shoshi, si dhe këngëtarët Kole Hasani dhe Bardhok Luca.

Këto ngjarje nuk ishin e janë thjeshtë shoshjane, por janë pjese e gjithë Dukagjinit, prandaj u ftuan personalitet më dashamirë dhe më aktive për shoqërinë tonë nga gjitha krahinat e Dukagjinit: Shalla, Pulti, Nikaj- Merturi, Shllaku, Temali, Malësia e Madhe, Lezha, Tirana e tjerë pa dalluar nga gjitha lagjet e Shoshit U ftuan studiues, historian, shkrimtar, poet, këngëtar, intelektual, ushtarak, si Kon-

sulli i Nderit i Republikës së Austrisë, në Shkodër Gjergj Leqejza, koloneli në pension, ish komandanti i Divizionit të Shkodrës, Flamur Muça, shkrimtari e përkthyesi e shkrimtari Meritan Spahija dhe shtetar të administratës publike të njësive Administrative të Dukagjinit dhe Shkodrës.

Të ftuarve ju dha mundësia që të shprehnin opinionin e tyre, për këto ngjarje historike dhe probleme që shqetësojnë fshatrat e krahinat tona.

Në ora 10 00 filloj programi i këtij manifestimi, me prezantueset Linda Kavaja (gazetare të TV 1) dhe mësuesja

nga Shoshi Vitore Kodra. Manifestimi u hap me kënga maja krahu të kënduar nga Geg Zefi e Gjon Kosteri, me titull “Preke Ndou e Marash Kola”.

Pastaj të gjithë me rrallë folën për historinë e lavdishme të Shoshit dhe Dukagjinit. Të veçanta ishin ligjërimi i Mark Pal Nikes studiues nga Nikaj Merturi, i cili ka zbardh shumë histori të vërteta për Shoshin në arshivat e Vatikanit. Një ligjerim tjetër i veçantë ishte i Kryetarit të shoqatës atdhetare “Dukagjini” Ndue Sanaj, me titull “Besëlidhja e Prekalit”, me 24 shtator 1919,



(vijon nga faqja 2)

Akoma më interesante u mendua zbulimi dhe vërtetimi i kromozonit Y tek meshkujt. Gjenetikisht, normalisht, tek gjinia mashkullore gjenden një Chromosom X dhe një Y, ndërsa tek ajo femërore, gjenden dy Chromosome X. Zbulimi edhe i një chromosomi të dytë Y tek meshkujt (tek disa prej tyre), për një kohë të gjatë u mendua si faktori i shfaqjes së meshkujve për agresionin dhe dhunën e tyre. Shumë nga kriminelët, tek të cilët u gjet chromosomi dopio Y, u liruan nga burgu duke e menduar si burimi i natyrshëm i agresivitetit të meshkujve. Ky zbulim mendohej si një atavizëm e lashtësisë, i domosdoshëm për të mbijetuar në botën e primatëve dhe egërsirave. Huluntimet gjenetike kanë vërtetuar se, afërsisht, një në një mijë meshkuj është pajisur me chromosomin e dytë Y. Në kërkimet e kryera tek kriminelët, rasti ishte dhjetë herë më i lartë. Ata ishin mesatarisht më të gjatë se të tjerët, me një kuotë inteligjence më të ulët se mesatarja dhe më të prirë në kriminalitet.

Në Amerikë numri i meshkujve që kryejnë delikte dhune është pesë herë më i lartë se ai i femrave, dhjetë herë më i lartë në vrasje dhe 100 herë më i lartë në përdhunime. Sipas gjenetikut Hengstschlaeger, e njëjta statistikë është edhe për Evropën.

Më parë, kur akoma nuk ishte njohur gjenetika, sjellje dhe veprime të tilla kriminale, shpjegoheshin me Teorinë e mjedisit. Teoria e mjedisit, i jep rëndësi të madhe faktorit mjedis në të diktuarit e sjelljeve, marrëdhënieve dhe veprimeve të individit. Kur flasim për mjedisin, kemi parasysh gjithë faktorët jashtë individit që përbëjnë botën rreth tij, faktorët natyrorë dhe politikosocialë. Mjedisit ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm në sjelljet dhe veprimtarinë e përgjithshme të njeriut. Psikologët e mendojnë rolin e mjedisit të baraspushtetshëm me atë gjenetik. Fëmijët e një familjeje të dhunshme, të cilët rriten dhe jetojnë në një shoqëri të dhunshme, në më të shumtën e rasteve rrëshqasin nga binarët e jetës dhe kthehen në vag-

ona përbindësh, si ata që shpëputen nga lokomotiva, duke shkatërruar gjithçka që ju del përpara. Eksperti kriminolog gjerman, Hans-Ludwig Kroeber thotë se, 70 deri në 80 përqind e kriminelëve janë rritur në familje të dhunshme. Fëmijët mësojnë, imitojnë dhe përvetësojnë në mënyrë perfekte ato që shikojnë dhe dëgjojnë nga prindërit e tyre. Nëse do të vëzhgojmë një të ri, rritur në një ambient asocial, pa rregulla dhe mes plehrave, do të vëmë re se sjellja e tij është fare “natyrore”, thjesht luftë për mbijetesë, pa e brejtur aspak ndërgjegjia. Nëse po këtë njeri e vendosim në një ambient social, ku sundon rregulli dhe humanizmi njerëzor, gradualisht fillon të përshtatet me rregullin dhe mënyrën moderne të jetuarit.

Megjithatë, problemi se cili është faktori parësor, geni apo mjedisit, ai që përcakton sjelljen e njeriut në shoqëri, duket si një problem aspak i thjeshtë për tu përcaktuar. Dhe do të mbetet i tillë edhe për shumë kohë për faktin se shkenca na i jep të dy këta faktorë të lidhur ngushtësisht

me njeri-tjetrin.

Kërkimet gjenetike në lidhje me dhunën, agresionin dhe krimin, vazhdimisht janë shoqëruar dhe vazhdojnë të shoqërohen me diskutime, diversitet mendimesh. Mbrojtësit e kriminelëve në bankën e të akuzuarit mundohen ta mbrojnë klientin e tyre, sipas rastit, herë me argumentet e trashëgimisë gjenetike dhe herë me ato të mjedisit. Mjedisit social mund të bëhet shkak për shpërthimin ose bllokimin (gjumëvënien) e genit kriminal. Në një mjedis, ku Shteti i së Drejtës nuk funksionon, ku monopolin mbi dhunën e marin një pakicë kriminelësh nga rruga, genet kriminale zgjohen menjherë dhe, dhuna, nuk ndalet.

Thuhet se të gjithë jemi lindur “budallenj”; çështja është sa mësuam dhe sa mundëm të mësojmë. Asgjë e përfunduar nuk lindet tek njeriu, me njeriun. Vetëm aftësitë trashëgoohen, të cilat tek bebet nuk mund të duken aq thjesht. Kështu mendon prof. dr. Horst Geyer.

Lekë Imeraj
shkrimtar, përkthyes, publicist.

mbajtur në fshatin Prekal të Shoshit. Ligjëruan dhe përshëndeten me rralle dr. Zef Gjeta, Konsulli Gjergj Leqezja, poeti Kadri Fikaj, poetja Mimoza Rexhvelaj dhe Prenda Sejdiqja, shkrimtari Ilmi Kurti; poeti Lazer Kodra, administratori i Njësisë Administrative të Shoshit, Ndoc Ashta; Gjon Dukgilaj- Mjeshtër i Madh, pronari i "TRADITA" dhe një studiues shumë i përkushtuar i traditës në Dukagjin, Gjergj Temeli, anëtar i grupit, emigrant, ardhur enkas nga Italia për këtë manifestim, është kryetar i shoqërisë "Bashkësia Shqiptare" me qendër në Toskana dhe të tjerë.

U kënduan disa këngë, në veçanti kënga "Ku i kam djemtë po pyesin nanat" nga këngëtari i mirënjohur Gjevalin Shani; akapale "N" Dukagjin mir knoj grykëholla", nga grupi i burrave; kënga e "Marash Tucit" nga rapsodi Gjon Kosteri dhe grupi; kënga e re "Mehmet Shpendi" nga këngëtari i mirënjohur Kole Hasani; kënga për "Dukagjini" nga Bardhok Luca; kënga lirike "Prej njaj shpati ti lshova sytë", nga këngëtari Ndoc Fusha; kënga "Moj Kosove", nga këngëtari Gjelosh Fusha. Pastaj vallja e shpatave e interpretuar nga valltaret e Ansambllit "Rugova" te ftuar posaçërisht për këtë manifestim. Me përfundimin e valles, kryetari i Ansambllit "Rugova", zoti Vasel Nikçi nderoj me titullin "Mirënjohja" Shoqatën kulturore "Besa Shoshi".

Një risi e veçante ishte prezantimi i veshjeve tradicionale, duke dal ne skene gjithë këngëtarët, valltaret e instrumentistët e këtij manifestimi dhe vallja "Mrizi i Zanave" e interpretuar me mjaft shpirt e ndjesi tradicionale nga nxënësit e shkollës 9 vjeçare "Dede Gjon Luli", ne Hot te Ri, nen drejtimin e mësueses se talentuar, koreografen Drita Zefi.

Në këtë manifestim u recituan dhe disa poezi kushtuar Shoshit e shoshjaneve nga vajza e djem të Shoshit.

Ky manifestim mjaft serioz dhe që paraqiti vlerat e Shoshit në fushën e folklorit dhe të historisë së lavdishme të tij, u mbyll me një foto e përbashkët me të gjithë pjesëmarrësit.

Përgatiti Gjon Ded Kosteri



DARKA E DUKAGJINIT NË NEW YORK

Trashëgimia kulturore e Dukagjinit po pasurohet nga viti në vit me krijimet dhe interpretimet e reja të paraqitura në veprimtaritë e ndryshme të zhvilluara kudo ku ka shqiptar e në veçanti ku ka dukagjinat. Më të dendura këto veprimtari zhvillohen në çdo fund viti duke e pasuruar në sasi e cilësi trashëgiminë kulturore – artistike të Dukagjinit. Kështu ndodhi edhe në fund të vitit që sapo mbyllëm. Nuk ka rëndësi se si emërtohen këto veprimtari: darka, nata, treveza apo ndonjë emërtesë tjetër, por rëndësi ka se sa vlera folklorike e artistike paraqesin. Në shumicën e këtyre veprimtarive dominojnë krijimet e reja sidomos të kantautorit të mirënjohur Fran Kodra. Është për t'u përgëzuar dhe entuziazmuar, sepse kudo ku ka dukagjinat, edhe pse të larguar nga vendlindja, mbartin me vete atdhedashurinë, vetitë dhe virtytet më të mira të trashëguara, që i qëndrojnë kohës dhe bëjnë përpjekje për të mbajtur gjallë vlerat më të mira kulturore dhe artistike, duke i pasuruar ato nga viti në vit, ku në këtë aspekt shquhen dukagjinat me banim në SHBA.

Në fund të vitit 2021, e pikërisht me 17 dhjetor u zhvillua një veprimtari folklorike në NEW – YORK të Amerikës, organizuar dhe financuar nga biznesmenët e suksesshëm dukagjinat zotërinjtë: Kujtim Funiçi nga Gaku i krahinës së Shalës, tashmë i afirmuar në organizimin e veprimtarive të tilla dhe Ndoc Sukaj nga Gjurajt e Pultit, djali i Ndre Lulashit, burrit të mirë të Dukagjinit,, që të dy shumë artdashës. E emërtuan darka e Dukagjinit në NEW – YORK, në të cilën morën pjesë kryesisht këngëtar dukagjinat, të cilët u paraqitën në pjesën më të madhe me krijimtari të reja nga Fran Kodra. Nga bujaria dhe mikpritja e pashoqe e organizatorëve të kësaj veprimtarie, u ftuan nga Shqipëria: Fran Kodra, Agim e Ndue Shytani, Prekë Mrishaj dhe Lekë Pecnikaj, duke ju hequr të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit atje. Kjo veprimtari u zhvillua në një ambient shumë festiv, në skenën e të cilit rrezatuan kostumet shumë ngjyrëshe të moshave e gjinive të ndryshme tradicionale të Dukagjinit, ku shumica e tyre janë pronë e të suksesshmit Funiçi, i cili para disa vitesh i ka sjellë nga Shqipëria me fondet e veta, të bëra nga artizanët dukagjinat, të cilat i përdor kur ka veprimtari të tilla. Kjo natë e folkut dukagjinat u hap me vallen e kënduar nga grupi “Jena dukagjinët e Lekës” e sjellë në skenë me koreografi të Angjelina Nikës, me tekst e muzikë të Fran Kodrës.

Lahuta e jonë, bashkudhëtarë e historisë ku brezat përcollën tek njëri-tjetri lavdinë e heronjve, ku Dukagjini e Malësia nuk e harruan kurrë. Çertifikimi i saj në Unesco po bëhet padrejtësisht nga shteti fqinjë, por lahuta e vjetër ilirjane do të jehojë dhe këndojë gjithmonë shqip. Të frymëzuar nga kjo padrejtësi e radhës që Evropa i bën emblemës së lashtë të traditës dhe folklorit tonë, vëllezërit Agim e Ndue Shytani u paraqitën me një baladë për lahutën të interpretuar shumë cilësisht, që ndër të tjera thuhet: *Moj lahutë ti*

je e jona / je përkund në malet tona / kombin tonë s'ke me ju nda kurrë / pa u nda shqipja me flamur /. Në përgjithësi çdo këngëtar që interpretoj në këtë veprimtari u ftua në skenë me nga një kartolinë formë bejteje, që u mirëprit nga të pranishmit, ku po veçojmë një ndër to: Ç' është ky za që borën shkri / ç'janë kta gurë të bardhë e të zi /n' Dardani me ra tupana / një Gëzim Nikë ka përkund kanga.

Gëzim Nika u paraqit me këngën “Mirësëtëgjeta Dukagjin”, disa vargje të të cilës janë: *Dukagjin hej mirësëtëgjeta / fjalët thuhën mot mbas motit / nderë e mirë përsat 'jënëjeta / shpija emikutedhe e Zotit /*.

Dyshja e talentuar, shumë e kërkuar e repertor gjerë, F. Kodra e Nd. Shytani fil-

fundit, interpretoj me zërin e tij melodioz këngë për Nikaj – Mërturin, ku thuhet: *Ka thanë shqipja n' palë t'flamurit / epja Zot Nikaj – Mërturit / epja Zot ma t' mirën hise / janë dy vllazën, janë dy fise /*.

Këngëtarja, tashmë e afirmuar, bashkëshortja e organizatorit Kujtim Funiçi, Bukurie Funiçi u paraqit me këngën “Çikat e Tropojës”, e cila u pëlqye nga publiku. I përhershmi në veprimtaritë folklorike që organizohen në Shqipëri e Amerikë, me një repertor shumë të pasur, Nikë Çarku kësaj radhe u paraqit me këngën: “Bjeshkët e Shalës l'shojnë një za”, në të cilën thuhet: *N'gurtë e Thethit kam lidh fillin / n' qiellin tëm e kam sjellë yllin / në skaj t'botës ku kam dalë / bjeshkëve t' Shalës ja u çoj një fjalë /*.



limisht u paraqitën me këngën e re: “S'ka si sofrë e Dukagjinit”, në të cilën thuhet: *E kanë thanë zanat e malit / e ka thanë rruga e shtektarit / e ka këndu kënga e kushtrimit / s'ka si sofrë e Dukagjinit /*, këngë e cila e beri spektatorin për vete.

Këngëtar i talentuar Pëllumb Vatnikaj, këngët e të cilit janë bërë hite vitet e

E ftuar speciale e kësaj veprimtarie artistik ishte këngëtarja e mirënjohur e muzikës së lehtë e popullore, Arbërie Hatërgjonaj, e cila u paraqit me veshje tradicionale dhe këndoj këngën “Bjeshkët e Shalës lidhën jezerin”, të cilën e interpretoj me shumë emocion dhe u duartrok-it shumë nga pjesëmarrësit.

Profesori i muzikës në shkollën artistike “Preng Jakova” të Shkodrës Prekë Mrishaj, i cili ishte edhe moderator i veprimtarisë, interpretoj siç din Ai, me një zë të kthjellët si ujë e bjeshkëve të Currajve të Epër ku e ka vendlindjen, këngën “Kufit e vjetër”, në të cilën ndër të tjera thuhet: *Kjo Shqipëri i vetmi shtet / ka në kufi shqiptart e vet / prej Evropës nuk don gja tjetër / veç ka i kena kufijt e vjetër / Tash sa vjet n' ansambël të shtetit / emër t'mirë tuj i lanë vetit / ku është folku e tradita / për ju sonte Lekë Pecnika /*. Kështu u prezantua nga moderatori solisti i Ansambllit të shtetit Lekë Pecnika, i cili këndoj një këngë moralizuese ku thuhet: *Se je pa para, nuk je fukara. Pra pasuria nuk të bën njeri me shpirt të madh.*



Këngëtar nga Puka Dionis Delia interpretoj këngën “Në kurbet s' kalohet jeta”, e cila si ide ka se të gjitha të mirat e botës me i pas si në vendlindje nuk ndihesh rehat.

Këngëtar Agim Shytani këndoj solo këngën “Dera e shtëpisë”, në të cilën thuhet: *O moj dera e shtëpisë / që rrin mbyllur tash sa vjet / ma thaj lotin e mërzi / që pas m' ndjek atje në kurbet /*. Nga vargjet dhe interpretimi emocionj shikuesit.

Fran Kodra, Ndue Shytani dhe Bukurie Funiçi interpretuan këngën: “S'ka si çikat e Dukagjinit”. Bija dhe nusja e Dukagjinit, Albina Ndrejaj u paraqit me këngën “Arbëri moj Arbëri”, me motiv për bashkimin e trojeve shqiptare.

Shumë mbresëlënëse ishte interpretimi i putirave nga grupi, një ritual, që është aplikuar gjithmonë në Dukagjin, në dasma dhe gëzime familjare, që këndoheshin në fund të dasmës apo veprimtarisë. Ato janë në formë bejtesh, të cilat kënaqnin pjesëmarrësit. Edhe në këtë darkë dukagjinat u interpretuan shumë cilësisht në fund të koncertit.

Moderator të kësaj veprimtarie ishin z. Prekë Mrishaj e znj. Kristina Delia, të cilët për asnjë çast nuk i mërzi të pjesëmarrësit me biseda të tepërta, siç ndodhë rëndomtë në shumë koncerte ku konferencierët zënë gjysmën e kohës. Ata thjeshtë paraqisnin këngën e këngëtarin.

Të gjitha këngët u shoqëruan nga grupi i valleve të përgatitura me mjeshtëri nga koreografa e talentuar Angjelina Nika.

Përveç dy djemve të Dukagjinit Funiçi e Sukaj, për organizimin e kësaj darke të magjishme të folkut dukagjinat, ndihmuan financiarisht edhe: Cakor restaurant Pelham Bay konstruksion LLC, Dardania Europjan Market, Eastwod Manor, si dhe dukagjinat me banim në Amerikë: Ndrekë Tonaj, Kujtim Mali, Lin Kumbulla, Dedë Prendaj, Gjini Markaj, Stive Saljani, Gjovalin Martini e Tonin Mbrapshtija. Këtë veprimtari artistik e filmoj TV Blue - Skaj, të cilin e transmetoj disa herë në ditët e para të vitit të ri. Siç e theksuam më lart, nga dukagjinat e NEW-YORK -ut me këngëtar vetëm dukagjinat e këngë të reja, u zhvillua një koncert folklorik që tashmë është bërë traditë, në një natë të paharruar në prag të festave të fund vitit të kaluar. Ishte një vlerë e shtuar në fondin e artë të trashëgimisë kulturore të Dukagjinit.

Të tilla veprimtari duhet të zhvillohen sa më shumë edhe në të ardhmen kudo ku ka shqiptar e sidomos dukagjinat, që nga Thethi e deri përtej oqeanëve, larg xhe-lozive, hatërbetjeve, përjashtimeve e vetpërkashtimeve, por në unitet e bashkëpunues midis të gjithë këngëtarëve e krijuesve kudo ku janë dhe sa më shumë sipërmarrës me mundësitë e tyre duke kontribuar dhe rritë në sasi e cilësi trashëgiminë kulturore të Dukagjinit, duke e pasuruar atë nga viti në vit.

Përgatiti
Prekë SHYTANI
janar 2022

Libri i Sospellos 1652

Relazione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Minori Osservanti Riformati del serafico P'ra S. Francesco nel Regno d'Albania, të autorit P. fra Giacinto da Sospello

HYRJE!

Libri, që po ju paraqesim është një dorëshkrim i pjesës së parë të shekullit XVII. Sipas shënimeve në krye të shumicës së faqeve të tij dhe disa datave të shënuara në vende të veçanta besojmë se materiali që përfshihet në të duhet të ketë filluar të shkruhet në vitin 1634 dhe duhet të ketë përfunduar në vitin 1650. Është i ruajtur në Bibliotekën e Bashkisë së qytetit të Feros në Itali të quajtur Biblioteca Civica "Romolo Spezioli" me skedën 4-E-7, n. 58, sec. XVII ndjekur nga titulli "GIACINTO P. Da Sospello – Relazione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Min.^{ri} Oss.^{ri} Rifor.^{ti} Del serafico P'ra S. Francesco nel Regno d'Albania.

Da diversi relationi d'alcuni P'ri Missionarij di detta Miss.^{ne} raccolta, ordinata, et aumentata."

MBI DOKUMENTIN

Autori i librit, materialin e mbledhur e ka përfshirë në një fletore me format A5 ose 21X15 centimetra, duke e shkruar me dorë, me mendimin për ta përgatitur për botim. Fjalën hyrëse ai e ka shkruar në fillim të tij, gjithsej 4 faqe, të nominuar me germa A, B, C dhe jo me numra. Në fund ka të shënuar vendin e shkrimit, Kotorr dhe datën 12 qershor 1652.

Më poshtë vazhdon shkrimi i librit, i numëruar jo siç veprohet zakonisht në atë kohë, ku shënohet numri i fletës nga ana e përparme dhe shënohet një numër i caktuar në mënyrë të vazhduar. Nëse kërkohet identifikimi për të shkruar fustota kur citohet dokumenti, për të identifikuar faqen nga ana e përparme, mbrapa numrit të fletës shënohet një *r* – që ka kuptimin në origjinal *recto*, që në gjuhën shqipe ka kuptimin faqja tek ose faqja përballë duke nënkuptuar anën e përparme të fletës. Në anën e pasme të fletës nuk shënohet numri i faqes. Për të identifikuar faqen nga ana e pasme shënohet numri i fletës që është i vendosur në anën përballë, e ndjekur nga germa *v* – që ka kuptimin *verso*, ose në gjuhën shqipe faqja e pasme e fletës së numëruar.

Në këtë libër nuk është ndjekur ky rregull, por faqet janë shënuar në vijimësi para dhe prapa çdo flete, duke filluar nga faqja 1 deri në faqen 506, pa asnjë shkëputje. Duke llogaritur edhe 4 faqet e para që po i konsiderojmë si hyrja e librit, janë gjithsej 510 faqe.

Formati i fletës është 14cm x 20cm, pra pak më i vogël se formati standard i sotshëm A5. Është shkruar tërësisht me dorë, me shkrim të imët. Materiali nuk është i dëmtuar, është i ruajtur mirë dhe është e mundur të lexohet, edhe pse me një farë vështirësie. Gjuha e përdorur në përgjithësi është gjuha italishte e kohës, por në shumë raste ka të shënuara fjalë në gjuhën latine, shqipe, kroate dhe rrallë në ndonjë gjuhë tjetër.

PËRMBAJTJA E LIBRIT

Përveç fjalës hyrëse, libri është i ndarë në 6 kapituj që vijojnë:

Në faqen numër 1, në krye ka shënimin "Relatione delle missioni dell'Albania" – dhe më poshtë shënohet kapitulli i parë.

Kapitulli i parë me titull: Cap.^o P.^o Del sito e stato dell' Albania, sue Provincie e Cristianità. Faqe 1.

Kapitulli i dytë: Cap.^o 2 Della Christianità delli monti d'Albania. Faqe 8.

Kapitulli i tretë: Cap.^o 3 Dell'origine, qualità e costumi delli Albanesi. Faqe 19.

Kapitulli i katërt: Cap.^o 4 Della neces-

sità che tiene l'Albania dell' Apostoliche Missi.ⁿⁱ Faqe 24.

Kapitulli i pestë: Cap. 5 Dell'origine delle Miss.ⁿⁱ Apostoliche mandati nel Regno di Albania. Faqe 30

Në këtë kapitull përfshihet historiku i 16 Misioneve, të kryera nga viti 1634 deri në vitin 1649, të shkruar nga faqja 35 deri në faqen 477. Në faqen 35 misioni i parë është i titulluar "Relatione delle Difficoltà, successi, gesti, frutti, travagli, e persecutioni occorse nella missione d'Albania dall'anno 1634 sino all'anno 1650." Këtu fillon historiku i misionit të parë dhe vazhdohet me historikun e 16 misioneve, që përfundojnë në faqen 477 me shënimin përmbyllës në gjuhë latine "Laus Deo, et Beatae Mariae".



Kapitulli i gjashtë: Cap. 6 et ultimo Cattalogo delli Miss.ⁿⁱ et Operarij ò Coad.^{ri} che hanno faticato nella Miss.^{ne} d'Alb.^a. Faqe 478

Në këtë kapitull ka një biografi të shkurtër të të gjithë klerikëve që kanë punuar në Shqipëri gjatë kohës që është përshkruar në këto misione.


Në faqen 499 deri në faqen 506 dhe të fundit ka një shkrim

në gjuhën latine, që nuk është pjesë e asnjë kapitulli me titull si më poshtë: "Die Xiiii Julij. In festa Sancti Bonaventure Episcopi, et Confessoris, et Ecclesiae Doctoris"

Në fund të këtij shkrimi ka një shënim me këtë përmbajtje: "Finis officij. Perasti, p.^{ma} die Augusti 1644 à P.^{re} Paulo à Mantua". Perasti është një vendbanimi në afërsi të Kotorrit në Malin e Zi, ku në vitin 1652 ndodhej një qendër kishtarë e rëndësishme e fesë katolike romane.

Ky shkrim bëhet në nderim të martirit Padre Paolo nga Mantova, martirizuar në afërsi të lumit Cem. Fra Paolo nga Man-

tova dhe fra Salvatore nga Offida, janë masakruar, duke u vrarë me shpatë, buzë lumit Cem, në Kelmend, më 14. 12. 1644.



NGJARJE DHE TË DHËNA ME RËNDËSI TË PËRSHKRUARA NË LIBËR

Një përshkrim sipërfaqësor të këtij libri e ka bërë studiuesi prof. Tadeusz Lewicki (1906-1992), i cili e ka shfletuar në vitin 1949, por mbasi dokumenti ishte jashtë sferës së studimeve të tij, ai pak është thelluar në përmbajtjen e këtij dokumenti. Biblioteka ku ruhet ky dokument ka mijëra faqe dorëshkrime dhe libra mesjetarë, por ky dokument është i vetmi ku flitet për Shqipërinë. Gjatë 370 vjetëve që ky libër ka qëndruar në këtë bibliotekë, mund ta kenë parë dhe shfletuar shumë studiues italianë dhe të huaj, por askush nuk ka shfaqur interesimin më të vogël për publikimin e tij. Autori i këtij libri dorëshkrim, Fra Giacinto da Sospello, ka qenë disa vite Vikar Apostolik i Shqipërisë dhe, përveç këtij libri, ka lënë edhe disa dokumente dhe relacione të shkruara në Arkivin e Propagandës Fide dhe në Arkivin Sekret në Vatikan, në Arkivin e Shtetit në Modena dhe në disa arkiva të tjerë, të publikuar një pjesë e tyre nga studiuesi shqiptar Injac Zamputi dhe nga studiuesi italian Lorenzo Tacchella.

Për praninë e këtij dorëshkrimi, informacionin e parë e kam marrë nga njoftimi i publikuar nga Lewicki. Jam interesuar pranë kësaj biblioteke dhe më kanë thënë që dokumenti nuk është publikuar asnjëherë dhe më kanë dhënë të drejtën e publikimit me disa kushte të vendosura në mënyrë zyrtare midis meje dhe Bashkisë së qytetit të Feros, në varësi të së cilës ndodhet Biblioteka e sipërpërmendur.

Ata më dhanë të skanuar me mundësitë teknike që ata kishin në institucionin e tyre, por rishkrimi (transkribimi) mbi këtë kopje ishte gati i pa mundur për shkak të cilësisë së kopjes së realizuar nga ata.

Për këtë arsye, unë ju kërkova të më plotësonin njërin nga dy kushte:

1. Të me jepnin dokumentin për ta nxjerrë jashtë bibliotekës për skanim në një studio të specializuar.

2. Të blija një skaner posaçërisht për këtë punë dhe të më lejonin ta skanoja vetë aty.

Mbas këtyre dy kushteve të propozuara, ata më thanë se dokumenti nuk mund të nxirret jashtë institucionit në asnjë mënyrë.

Si zgjidhjen më të mirë ata më propozuan të më gjenin një specialist shumë profesionist, tek i cili ata kishin

Lajm

Mbas publikimit të librit tim mbi Dioqezën e Pultit, shumë banorë të zonës së Dukagjinit më kanë telefonuar dhe kanë shfaqur interesin e tyre për këtë studim dhe për të pasur informacione edhe më të zgjeruara. Gazeta DUKAGJINI organ i shoqatës atdhetare me të njëjtin emër, ka publikuar një numër të artikujve të mi mbi historikun e kësaj treve dhe kanë shfaqur interesin për të pasur informacion të tjera më të thelluara. Me ndihmën e intelektualit nga Shoshi i Dukagjinit, Prof. Dr. Zef Gjeta, u bë e mundur të përgatisim për botim disa relacione nga Arkivat e Vatikanit, të përdorura nga unë për studimin mbi këtë dioqezë, disa të publikuara në gazeta dhe revista të ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë si tek Hylli i Dritës, Dukagjini, Mirdita, Vjetari, Nacional, Gazeta Shqiptare, Dielli, Dita etj. Në fund të çdo relacioni është shënuar edhe burimi i saktë i dokumentit. Menduam që ti paraqesim me disa plotësime, të bashkuara të gjitha, në një libër modest për personat e interesuar. Këtu janë publikuar 73 dokumente dhe kemi në proces përgatitjeje edhe një numër akoma më të madh të dokumenteve



kryesisht nga Arkivi Sekret i Vatikanit të cilët nuk janë publikuar më parë dhe janë me rëndësi për historinë e komit tonë sidomos për shekujt XV, XVI, XVII dhe XVIII. Të dhënat e këtyre dokumenteve i përkasin kryesisht zonës veriore ku popullsia mbeti e besimit katolik roman mbas pushtimit turk. Për zonat e banorëve të besimit skizmatik dhe muhamedan, të dhënat janë minimale, megjithëse të rëndësishme. Libri është i destinuar më së pari për publikun e gjerë kryesisht nga krahinat e Mbishkodrës, Tropojës dhe të zonave për rreth tyre. Zakonisht studiuesit e dokumenteve, midis tyre edhe au-

tori i këtij shkrimi, preferojnë që të punojnë direkt mbi dokumentin origjinal dhe jo mbi atë çfarë kanë përpunuar të tjerët me rishkrim dhe përkthim. Gjatë punës time mbi dokumentet e rishkuara, kur i kam ballafaquar me shkrimet origjinale, më ka rezultuar që janë publikuar me gabime deri në tjetërsimin e idesë ose të fakteve të shkruara në origjinalet me shkrim dore. Nëse e shikoni këtë publikim timin, është vetëm në gjuhën shqipe dhe i pa ballafaquar as me fotokopjet e origjinaleve as me rishkrimin në gjuhën italiane, prandaj ata që kërkojnë të kryejnë një studim të bazuar mbi dokumentet e përkthyer duke

shënuar edhe burimin e tij, është me vend që ti referohen origjinalit kur e kanë të mundur. Personat të cilët e kanë të pamundur leximin e origjinaleve të shkruara me dorë, duhet të mjaftohen me atë që kam paraqitur në këtë libër. Duhet të jetë e qartë për të gjithë lexuesit që është bërë një përkthim i lirë, duke u përpjekur që të japim idenë që kanë dashur të na përcjellin autorët e relacioneve origjinale, pa i qëndruar besnik përkthimit fjalë për fjalë. Kemi kërkuar në vijimësi ndihmën e institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe të atyre fetare për të bërë një publikim dinjitoz të dokumenteve të përpunuar nga ana jonë. Deri më sot, nuk kemi gjetur mbështetje financiare as nga organizmat që përmenda më sipër as nga biznesmenët me origjinë nga këto zona. Ata që merren me këtë lloj punimesh, e kanë të qartë koston e publikimit të dokumenteve në dorëshkrim dhe është e tepërt të ndalem dhe të tregoj për vështirësitë që kemi. Nëse do të na kishin mbështetur nga ana financiare, publikimet tona do të ishin shumë herë më tepër dhe më cilësore.

Ju faleminderit!

Dr. Mark Palnikaj,

Tiranë, me 12 janar 2022

besim për të bërë skanim profesional dhe pagesën e specialistit ta kryejta unë.

E pranova kushtin menjëherë dhe bëmë vërtetë një skanim shumë të mirë, mbi të cilin mund të punohet në mënyrë shumë komode dhe leximi të ishte i saktë.

Leximi dhe rishkrimi në mënyrë korrekte e një dorëshkrimi kaq të madh është një punë mjaft e vështirë për një studiues. Zakonisht këtë punë e kryejnë persona që janë të specializuar në degën Paleografi, Arkivistikë dhe Diplomatikë. U munduam të merreshim vesh me dy specialistë që kishin mbaruar këtë shkollim në një universitet në Lecce të Italisë, por ata, mbasi kaluan 6 muaj hoqën dorë nga kontrata pa rishkruar asnjë faqe.

I ndodhur në këto kushte, gjetëm zgjidhjen duke u lidhur me një specialist në pension në Itali, i cili pranoi më tepër për miqësi ta rishkruante librin në kompjuter, me kushtin që të kryente rreth 98% të punës pa mbajtur përgjegjësi për ato fjalë ose rreshta që nuk mund t'i lexonte ose do t'i shkruante gabim. Korrigjimi do të bëhej nga unë dhe përgjegjësia do të ishte jo e atij, por e imja. Rishkrimi zgjati rreth një vit dhe falë punës së palodhur dhe shumë profesionale të mikut tim dhe të korrigjimeve të kryera nga unë dhe bashkëpunëtorëve të mi në Shqipëri dhe në Kosovë, tani materiali i rishkruar është gati për përkthim dhe për botim.

Është habi e madhe se si ka mundësi që një dokument kaq i rëndësishëm dhe me një volum kaq të madh shkrimi nuk u publikua për 370 vjet asnjë faqe e tij. Kjo ka ndodhur, ndoshta, nga fakti se personat që e kanë parë nuk kishin si objekt të studimeve të tyre të publikonin të dhëna për historinë e Shqipërisë.

I ndodhur në këto kushte, vendosa që t'i hyja punës për publikimin e plotë të këtij dokumenti, pa marrë parasysh kostot financiare dhe mundimin e madh që do

të më shkaktonte ky publikim. Mbas një viti e gjysmë pune këmbëngulëse, sot libri është gati për publikim.

ÇFARË PËRMBAJTJE KA LIBRI?

Siç e përmendëm edhe më sipër, libri është i ndarë në gjashtë kapituj dhe përshkruan historikun e 16 misioneve fetare, të kryera nga autori nga viti 1634 deri në vitin 1650. Aty përshkruhen përpjekjet që bënin misionarët katolikë për edukimin fetar dhe social të popullsisë shqiptare ku ata punuan.

Libri, përveç anës fetare, e cila përbën afërsisht gjysmën e këtij publikimi, dhe për këtë pjesë nuk do të flasim në këtë fjalë hyrëse, përmban anën sociale dhe historike për të cilën do të japim shkurtimisht disa njoftime.

Në kapitullin e parë ka një përshkrim të shkurtër mbi historikun e krishterimit të Shqipërisë. Në faqen 7 jepen të dhëna me rëndësi për krishterimin në Durrës dhe zonat në varësi të tij që shtriheshin nga Myzeqeja deri në Burrel.

Në faqen 10 përshkruhen Kelmendasit, të cilët ai i vlerëson si "Më të fortët shqiptarë të fushës dhe të maleve".

Në faqen 12 flitet për Berishën dhe Sapën dhe për një betejë të tyre me turqit. Në faqet 16 dhe 17 flitet për zonat e Matit dhe përshkruan se ku ka lindur Skënderbeu. Në faqen 23, përshkruan se në kundërshtim me mësimet e fesë, banorët festonin festat fetare me abuzime të mëdha dhe me gabime, që për fretërit katolikë ishin të palejueshme. Në faqen 114 flet se si disa njerëz të këqij, kishin vjedhur vulën e fretërve dhe kishin vulosur dokumente që i kishin hartuar vetë, për të komprometuar dhe penalizuar fretërit në raport me sundimtarët turq. Kjo ju ka hapur atyre shumë telashe, sepse arrestohen shumë priftërinj dhe paguhen shumë para për lirimin e tyre, edhe pse ishin të pafajshëm.

Në faqen 19 jepet një historik i shkurtër i Shqipërisë, bazuar mbi dokumente që sot cilësohen si të pavërteta, në lidhje me origjinën e popullit tonë.

Në faqen 123 Sospello viziton Kishën e Deçanit dhe na jep informacione me rëndësi. Si përkthyes merr Ipeshkvin e Dioqezës së Shkupit, Dom Andrea Bogdani, xhaxha i Pjetër Bogdanit, i cili zotëronte gjuhën shqipe, serbishte, turke dhe italiane. Në faqen 131 ka përshkruar me detaje luftën e Kelmendasve me 700 burra kundra ushtrisë së Vuçi Pashës së Bosnjës me 30 mijë ushtarë dhe humbjen e pabesueshme që kelmendasit i shkaktajnë kësaj ushtrie. Po aty, përshkruan edhe për sjelljen e këtij Pashai me banorët e fushës, që përshkruhet si sjellje korrekte dhe fisnike. Në faqet 141 dhe në vazhdim, në tre faqe, përshkruhet me imtësi se si pajtoheshin gjaqet në Tropojë midis Gashit dhe Krasniqes. Çuditërisht, ajo metodë është përdorur deri në vitin 2000 në disa zona të Tropojës. Në faqen 142 përshkruan hollësisht se si kapërcehej Drini me rrëshiqe prej lëkure, metodë që është përdorur deri në vitet 1970 në fshatrat e Pukës. Në faqen 149 përshkruan shkollën që kishin hapur priftërinjtë në gjuhën shqipe për fëmijët 8 deri 10 vjeç, por edhe më të mëdhenj. Aty tregohet se shkolla nuk kishte karakter vetëm fetar, por edhe shkencor. Në faqen 154 përshkruan ngjarje supersticioni, në kundërshtim të plotë me mësimet e Kishës Katolike, ku besimtarët në disa fshatra të Zadrimës, në mënyrë shumë antihumane zhvarrosnin të vdekurit dhe i masakronin. Në faqen 155 përshkruhet se si fra Giacinto dhe Ndre Bogdani u munduan të bënin pajtimin e kishave të ritit latin me ato skizmatike serbe. Përshkruhet vizita e Sospellos në shtëpinë e Bogdanit dhe disa rrethana në të cilat ai punonte. Në faqen 216, përshkruan se si i persekutoinin gratë në famullinë e Perastit në Mal të Zi, duke i akuzuar si shtriga. Në faqen 239 përsh-

kruhet se si fshatarët e Iballes përgatisnin litarë nga lëvoret e blirit dhe kishin arritur të bënin kapërcimin e njerëzve nga njëra anë në tjetrën me një pajisje që rrëshqiste mbi litar. Nga faqja 275 deri 278, përshkruhet me detaje si veprime në Tropojë për pajtimin e gjaqeve midis fiseve Gash dhe Krasniqe. Në faqen 282 përshkruhet se si jetonin gabelët në komunitet me shqiptarët. Në faqen 302 dhe në vazhdim tregohet për ekspozitat që organizoheshin në Kishën e Shën Aleksandërit në Orosh, duke na dhënë detaje mjaft interesante për studiuesit. Në faqen 311 shpjegon se si u transferua në Bytyç misioni i Gashit (nga Geghyseni i sotëm) në vitin 1643. Në faqen 337, përshkruhet vrasja e dy meshtarëve të fshatit Hot nga Kelmendasit, duke sjellë të dhëna që plotësojnë ato që kemi ditur deri sot. Sospello ishte bashkëkohës dhe epror i tyre. Dëshmia e tij ka vlera historike. Në faqet 347 dhe 348 shpjegohet me imtësi për supersticionin në fshatrat e Kthellës dhe Trafandinës, ku bëhej zhvarrosja dhe masakrimi antihuman i kufomave. Në faqen 366, duke folur për misionin në zonën e Hasit, përshkruan dimrin e ftohtë, ku ngrihej vera në gotë dhe Drini në lëvizje ngrinte duke bërë të mundur kalimin mbi akull të njerëzve dhe të bagëtive. Në faqen 403 dhe 404 përshkruhet bashkëpunimi i shqiptarëve katolikë me gjeneralin Dalmat në luftë për çlirim kundra turqve. Në kapitullin e 6 dhe të fundit jepet një biografi e shkurtër e personave që i shërbyen Kishës në vitet kur Sospello punoi në Shqipëri.

Këto informacione që përmenda shkurtazi këtu, e bëjnë këtë libër një burim me rëndësi për informacionet që përcjell për zhvillimet historike dhe sociale në Shqipërinë e asaj kohe.

Ju faleminderit!

Mark Palnikaj,

Tiranë 15 shkurt 2022

Nikaj-Mërtur, ku çel lulja përmbi gur

- Një guidë në vendin e origjinës -

Duke u marrë me historikun e fshatit Kthellë-Epër dhe të familjes time Kalaj, m'u zgjua kureshtja për të mësuar më shumë për rrënjët e mia. Në vitin 2008, në librin Kthella-Epër, pata shkruar: "Gjithnjë, nëpër hullinë e gojdhënës, rreth shekullit 16, në fshat erdhi fisi i kalajve. Ata u pranuan në fshat si të barabartë, në kojrië, pa të drejtë për të hyrë në tokën nën ujë dhe pa të drejtë vathi. Kalajt, me origjinë nga Malësitë e Veriut, (Malësia e Gjakovës), ishin vendosur në fshatin Skuraj, fis me Ukhasanët. Një komandant ushtarak turk, me 12 zaptie, ishin ngarkuar për mbledhjen e taksave nëpër fshatra. Lakmia e tij për vajzën e madhe, i errësoi arsyen dhe kapërceu normat njerëzore, duke i kërkuar vajzën, por jo për nuse. Shtëpia e madhe e Kalajve, mbushur plot 9 djem të rritur, u tërbua. Si do ta kapërcenin këtë kob, ndaj vendosën të hakmerren. Pasi mbushën me kashtë e barot katin e parë të shtëpisë, u çojnë fjalë zaptijeve, të vijnë për darkë për t'i plotësuar dëshirën komandantit. Fëmijët dhe gratë i larguan nga shtëpia. Përgatitja që e plotë dhe e studiuar mirë. Pas gostisë, ku rakia dhe vera u derdhën lumë, e ushtarët dhe komandanti kishin arritur kulmin e kënaqësisë, në kullë shpërtheu flaka. Kush arriti të largohet nga zjarri, gjeti vdekjen në pritat e ngritura. Asnjë prej të trembëdhjetëve nuk shpëtoi i gjallë... Kalajt ju drejtuan malësisë dhe zunë vend në Shullanin e Arëve Kalaj, në Kthellë-Epër. Kalajt u shpërdanë edhe në Dibër, Mat, Shkodër Kosovë etj. Me siguri, ata, nuk e kishin menduar se stërnipi i tyre, pas më shumë se 400 vite do të kërkonte rrënjët nga ka ardhë?!

Një detaj i ri për origjinën:

Para disa viteve, kur po vazhdoja pushimet në plazhin e Durrësit, marr një telefonatë. Matanë telefonit dëgjova: "Jam Mark Palnikaj, - më tha, - kam nevojë me të takua". Profesor Marku ishte një studiues e hulmues dhe kishte publikuar shpesh në rrjetin social, rezultatet e zbulimeve të tij, por personalisht nuk njiheshim. E lamë takimin tek një kafe në Unazën e re të Durrësit. Ai erdhi me një shok, kurse unë mora me vete vetëm librin Kthella-Epër të cilin mendova t'ia dhuroj.

-Po përgatitem për të bërë një monografi të zonës së Nikaj-Mërturit,- më tha. - Gjatë gërmimit në arkivat e Vatikanit, vura re se për një periudhë 200 vjeçare, Rreth viteve 1500-1700), Nikaj-Mërturi kishte vetëm 24 shtëpi. Emrat ndryshonin ndër vite, por shtëpitë as nuk ishin shtuar as nuk ishin pakësuar. M'u desh të ndjek familjet që rridhnin nga kjo zonë dhe gjeta ngulimet e tyre të reja, në Gjakovë, Pejë, Prizren etj. Ndër ta, ndoqa Gjobardhin, i cili ishte ngulë në Skuraj. M'u desh të takoja një plak 90-vjeçar nga dera e Gjobardhëve në Skuraj i cili më tha: "Ne Gjobardhët e kemi prejardhjen nga Nikajt e Tropojës në Malësinë e Gjakovës. Jemi një fis me Kalajt e Kthellës-Epër dhe me Ukhasanët e Milotit".

U binda se thëniet e gjyshit tim dhe hulmimet e Profesor Mark Palnikaj, përkonin në një pikë. Origjina e fisit të Kalajve është nga Nikaj-Mërturi.

Rinjohje me Frrok Vukajn

Thonë se vetëm mali me mal nuk piqen, se njerëzit takohen një ditë. Punoja në shkollën 9- vjeçare nr.2, në Rrëshen, nëndrejtor. Në shkollë u paraqit profesori i njohur Musa Kraja, i cili shoqërohej nga një person tjetër, të cilin nuk e njoha, por me shkathtësinë që e karakterizon, bëri prezantimin dhe mori iniciativën për të folur. Dukej njeri fisnik, që në veshje, në pamje, në elegancë, por një të folur letrar me theks karakteristik të Tropojës. Flokët e drejta, të dendura, por të thinjura, trupi i gjatë dhe i drejtë, e tregonin më të ri se mosha që kishte. Kishin kaluar rreth 45 vite, nga koha kur të dy vazhdonim shkollën e mesme pedagogjike "Sh.Juka", jo në të njëjtin vit, por emri i tij më tregonte diçka që e vuri në lëvizje memorien time.

-Jam Frrok Vuka, më mban mend, - m'u drejtua. - Kemi qenë bashkë në pedagogjike.

-Me siguri ishte interesuar që më parë, për të gjetur ndonjë nga shokët e tij të pedagogjikes "Shejnaze Juka" Shkodër.

-Mark Kalaj. - ju prezantova unë.

-Të kujtoj shumë mirë, Mark, m'u drejtua dhe natyrisht kërkoi edhe mbështetjen time.

Nga ajo kohë u takuam edhe herë të tjera, shkëmbyem numrat e telefonit dhe ruajtëm lidhjen.

Shkas për një lidhje më të fortë u bë motra ime, Davita, e cila gjatë pushimeve në kavalishencën e ushtrisë në Durrës, para dy viteve, u miqësua, si shoqe pedagogjike të Elbasanit me Dilën, gruan e Frrokut, një pukjane, nga mësueset e daluara të zonës së Nikajve, një grua që me qëndrimin, fjalën, sjelljen, të impononte respekt.

Indicie për një guidë në Nikaj-Mërtur.

Kisha shkëmbyer një bisedë telefonike me Frrokun. Më tha, se kishtë dalë në vendlindje me gruan, Dilën dhe do të qëndronte deri nga vjeshta atje. Një mëngjes, kur po kthehesha nga kafja e mëngjesit, bije zilja e telefonit dhe përsëri Frroku. Zëri i tij m'u duk më entusiazat dhe i vendosur: "Ka folë dhe Dila me Daviten dhe të mora, pasi kam dëshirë të vini bashkë me motrën Davite, të rrimë kënde, pasi është fresk. Kemi kushte normale për ju dhe bëjmë ndonjë vizitë këtyre malësive. Mos e humb rastin, pasi në shtëpi jam vetëm unë dhe gruaja, fjetjen e kemi normale, kurse për ushqim, nuk do të shpenzojmë ndonjë gjë të madhe, ato që kemi për vete, shtëpia e zotit dhe e mikut".

Të them të drejtën, që kur kisha dëgjuar

se prejardhja jonë ishte nga Nikaj-Mërturi, isha bërë kurioz ta njoh këtë zonë, vendin e origjinës time, rrënjët e mia të hershme. Kisha qenë vetëm një herë në vitin 2014, një natë në luginën e Valbonës, por atëherë sapo kishte filluar turizmi i aventurës dhe duhej të pronotoje për fjetje disa kohë më parë, ndryshe rrezikoje të mbeteshe jashtë. Ishte një rast që duhej shfrytëzuar, pasi nuk përsëritesh më, aq më tepër se unë tashmë kam dhe moshë e cila nuk do të më lejonte ta bëja këtë guidë. I përgjigja se do ta diskutoja, por nuk i premtova, për arsytet e mija familjare. Në dilemën mes dëshirës dhe mundësisë, mora në telefon motrën Davite, caktuam datën për nisje, ditën e premtë datë 6 Gusht 2021.



Në Luginën e Valbonës

U nisëm me mikrobuz të linjes, nga Tirana për Bajram Curr. në orën 8 të mëngjesit. Pas një udhëtimi të këndshëm nga Gjakova, arritëm në qendër të Qytetit Bajram Curri në orën 14.00. Na u shfaq para sysh, një qytet i rilindur, një qendër e rikonstruktuar, me pedonale qëndisur me gurë të bardhë të bjeshkëve, Bacë Bajrami madhështor, shtëpia e Kulturës, shkolla e mësme, qendra e komunës, fasada të pallateve të freskuara, me trotuare të rregulluara me shije, fytyra njerëzish të qeshur. Njerëz nëpër kafene, djem e vajza të gjatë e të hijshëm, tek ecnin serbes. Sapo na lindi ideja për një foto me Bacë Bajramin, shfaqet i qeshur dhe na uron mirëseardhjen Frroku.

Dreka, në një nga restorantet e qendrës, ishte e thjeshtë, por me një dashamirësi nga personeli i shërbimit dhe ushqimi me shije. Frroku kishte porositur Fredin, një djalë të ri të fisit të tij, që do të na shoqëronte me benzinë e tij, për në Luginë

nën e Valbonës. U nisëm pa humbur kohë. Rruga ishte e asfaltuar, e mirëmbajtur dhe ndaleshim aty këtu për të bërë foto e për të shijuar bukuritë mahnitëse të kësaj lugine, që për nga bukuria nuk gjen shoqe tjetër në glob. Pothuaj, gjithë lugina kishte pësuar ndryshime gati të pakrahasuesme. Secili prej banorëve të Luginës kishin rikonstruktuar shtëpitë, i kishin përgatitur për bujtina. Pjesa e sipërme e luginës, ishte bërë një qytet i vërtetë, me bujtina për turistët, ndërtauar me shije, kryesisht me dru dhe të pisura më së miri. Lugina kishte gjallëri. Lëvizjet e makinave ishin të shumta dhe turistët të huaj dhe vendës ishin plot. Malet e thepisura dukej sikur qëndronin mbi kokë, bora ende ishte prezente, një fllad i lehtë të përtërinte shpirtin. Trofta rritej në rezervat, resor-tet po merrnin dorën e fundit, U ulëm në hijen e bredhëve dhe në flladin e tyre shijuaam kafënë e pasdites. Furgonët pritnin gati për guida më në veri, kurse njerëzit e shërbimit kishin nxjerrë paisjet e tyre edhe në terren të hapur. Pas fotove të aparatëve, u kthyem në zonën për ku ishim nisur, në Nikaj-Mërtur.

Shtëpia e Frrok Kolë Vukës

Në shtëpinë e Frrokut, makina arriti rreth orës 7 të mbrëmjes. Deri ku ndahej rruga e Lekbibajve me të Mërturit rruga ishte e asfaltuar. Përpara, na doli, duke buzëqeshur, e zonja e shtëpisë, mësuese në pension, Dila. Na uroi mirëseardhjen. Shtëpia e Frrokut, në hyrje të fshatit Shëngjergj ishte e mirëmbajtur dhe plot dritë. Vitin e kaluar kishte rikonstruktuar çatinë. Na gostitën me të gjitha të mirat e një tryeze malësie dhe me shpirtin e pastër e me shumë ngrohtësi. Ishim të lodhur, por bisedat na e larguan gjumin deri afër mesnatës. Fjetja ishte shumë e

rehatëshme dhe nata e freskët që të detyronte të përdorje batanien.

Mëngjesi i të nesërme ishte i freskët. Hodhëm krahëve edhe ndonjë bluzë për t'u mbrojtur nga ndonjë ftohtë. Dila përgatiti një ushqim karakteristik i zonës, mazë, (një lloj qulli me miell misri dhe me gjalpë), shumë e shijshme. Nuk munguan gjalpi, mjalti, djathi i dhisë, qumështi i lopës, kastravec, speci i skuqur, të gjitha të krahinës, të freskëta dhe me shije.

Guida në krahinë

Shetitja e ditës nisi në rrugën automobilistike të fshatit, një rrugë e pa asfaltuar, nën freskun e pyllit të gështenjave, arrave dhe lajthive që kishin nisur të piqeshin. Ishte rruga e zakonëshme që kishte bërë Dila çdo ditë për në shkollën e fshatit Shëngjergj. Ndërkohë ne bisedonim me Frrokun i cili kishte shërbyer si mësues e Drejtor i shkollës së mesme në Lekbibaj për një kohë të gjatë. Ai e njihte mirë zonën, fliste me nostalgji për të, pse jo dhe

Vuksan Gela i Gjon Grudës nga Suma erdhi dhe u ba ma i pari i Malit të Grudës



nga Prof. Gjon Frani Ivezaj

Që nga mesjeta e hershme e deri në mesjetën e vonë shkencë pranon faktin se vendbanimet e mëdha përfshi edhe qytete, janë identifikuar nëpërmjet familjeve më të fuqishme të cilat gëzonin një farë reputacioni juridik dhe ekonomik për atë kohë. Ky fakt na identifikon edhe familjet e medha e të fuqishme në malësi prej të cilave zunë vend edhe toponimet krahinore që sot njihen si "Male" dhe jo fise sikurse në antikitet, pasi mali në vetvete nuk është gjenetikisht homogjen siç është fisi me përkatsi gjaku të njëjtë. Madje në Malësi të Madhe "Mali", pothuajse gjithmonë na del disa fisesh pasi malet në vetvete kanë të përfshirë jo vetëm të fortët ku në të shumten e rasteve ishin të ardhur (nomadë apo kolonë siç quheshin më heret), por edhe autoktonët të cilët ishin trashëgimtarët më të hershëm vendas. Për ta vertetur këtë fakt do të zbëthojmë në mënyrë kronologjike Malin e Grudës dhe përkatsitë gjenetike sipas të gjitha burimeve që na përftohen nga autorët vendas dhe të huaj. Sipas të dhë-

ave burimore të shekullit të XVI thuhet se Vuksan Gela ishte i pari i Grudës dhe se ishte i ardhur në Grudë në vitin 1531 nga Sumës e Postribës. Ardhja e tij në Grudë në një farë mënyre ishte e justifikueshme për vendasit pasi kishte qenë vazhdimisht në sytë e vezirave të Shkodres si një trim me za dhe armik i perandorisë prej të cilit kishin patur shumë dëme e humbje jetësh. Ai vetë vazhdimisht u zinte pritë ushtarëve që zbrisnin me misione të caktuara për në Shkodër pohonin sumjanët. Ky fakt kishte revoltuar edhe vetë Vezirin i cili kishte lëshuar urdhër arresti për të, çka e detyroi me leshua vendlindjen e tij e me ardhje në majen e Qafës së Diellit në Grudë, apo Malit të Labeatëve -sipas shënimeve të Arqipeshkëvit të Kotorrit, A.Konteansiano Parma aso kohe. Vuksan Gela i Gjon Grudës duke qenë se ishte i përndjekur nga turqit në Sumë vendos që bashkë me familjen e tij (fillimisht baben e gjyshin e mandej pjesa tjetër e familjes) të strehohet në një shpellë në Qafë të Di-

ellit, diku në majen e Sukës së Grudës së sotme, emër të cilin thuhet se Gruda e ka marrë nga trunghi i Vuksan Gelit, pra nga Grud Suma. Ardhja e tyre në këtë qafë mali nuk shkaktoi asnjë hatërmbetje apo problem social pasi në atë kohë kishte shumë përndjekje e trazira për shkak të gjëndjes së rënduar ekonomike nga taksimi shtetnor dhe feudal si detyrim i dyfishtë i caktuar me ferman (ligj), madje, mund të thuhet se ardhja e kësaj familje me potencial të mkamun ekonomik dhe me numër të madh antarësh shihej si një krahi i fortë për mbrojtje në rast rreziku. Sipas të dhënave të asaj kohe në relacionet e Kishës si banor në atë qafë mali përmenden edhe familja Prëk Pecit dhe një grua e ardhur. Në këtë vend Vuksan Gela mbollti dhe i dha jetë edhe "Lisit të tamlit" duke i dhënë kështu emër edhe Malit të Grudës. Ai lindi katër djem, djali i madh quhej Ivza, nga i cili u degëzuan barku Ivezajt, i dyti djalë quhej Nikë, nga morën emrin Nikajt e Grudes, i treti djalë ishte Gjoci nga i cili u degëzuan barku Gjollaj, dhe i katerti djalë ishte Sini, prej të cilit

Shpella, që mendohet se, Vuksan Gel Gjoni, është vendosur për të parën herë në atë shpellë, në Gruden e tashme, vedbanimi i pare i Vuksan Geles

u degëzuan barku Sinishtajt. Këto fakte dëshmojnë se Kulla e mëkëmbur Vuksan Gelës ishte familja dominuese dhe më me influencë për atë kohë nga e cila lindën nënfiset e medha të Grudes, Ivezajt, Nikajt, Gjollajt, Sinishtajt duke i dhënë kështu edhe një emër dinjitoz Malit të Grudës në Malësi të Madhe, aq sa në një dokument zyrtar të dt. 26 qeshor të vitit 1688 me kryetull: Letër e senatit venedikas drejtuar proveditorit të përgjithshëm, në të cilën flitet për suksesin e luftimeve të Kuçit, Grudës dhe Kelmendit, ashtu dhe për forcimin e garnizionit të Medunit na del në pah një fakt shumë domethënës sa i takon zhvillimit demografik dhe foca e unitetit fisnor në përballje me sundimtarin. Ajo që na përftohet nga të dhënat e shkruara vlejnjë të theksohen si dëshmi e pranisë shumë familjeve autoktone (vendase) apo ato të shpërngulur nga migrimet, të cilat në ulje -ngritjet e moteve nën rrebeshet e historisë ecën paralelisht me këto nënfise dhe bënë epokën e tyre si bashkëvllazën teritori nën kujdesin dhe mbështetjen e kësaj familje Sumjane.



me mburrje. Përballë nesh, në krahun e djathtë të lumit të Nikaj -Mërturit, vinin me radhë fshatrat e zonës së Nikajve: Lekbibaj, Peraj, Gjonpepaj, Curraj, Curraj i Epërm dhe Qeresh. Krahu i majtë i lumit, këtu ku ishim ne, ishte krahina e Mërturit me fshatrat Shëngjergj, Btoshë, Tetaj, Raja, Palc, Salcë dhe Brisë.

Rreth tyre, ngriheshin me shpatë të thikëta malet rreth 2000 m të larta si: Mali i Kakisë, Rruku, Maja e Hekurave, Maja e Korës. Curraj i epërm, rrethohet nga Maja e Boshit, Mali i Zhabores etj. E vetmja Qafa e Kolshit e lidh këtë zonë me Luginën e Valbonës. Me krenari Frroku, thotë se asnjë pushtues nuk arriti të vendosë pushtetin në këtë zonë. Është një zonë katolike, por me mbiemra të ndërthurur, për arsye të mbijetesës në kohën e pushtimit turk. Një zonë me zgjuarsin natyrale, me njerëz të mençur që kanë dhënë kontribut të shquar në zgjidhjen e problemeve. Zona e Nikaj Mërturit mburret me mendimtarët popullorë: Nikë Mengja, Deli Sokoli, Tunxh Myftari, (Bajrajtari i Mërturit), Kukul Ndou i Currajve të Epërm, etj. Shkuam në qendër ku ishin shkolla, ambulanca dhe varret e fshatit. Vetëm banorë kishte pak.

Kjo zonë është shumë arsimdashëse me etje të madhe për dije dhe kulturë. Këtu, në fshatin Gjonpepaj, është hapur edhe shkolla e parë në krahinë e Gjakovës, në

vitin 1917, me mësues Atë Nikoll Kolën. Shkolla dikur kishte gjallëri. Në shkollën e mesme të bashkuar të Lekbibajve, para viteve 90-të kishte mbi 600 nxënës. Nga statistikat e grumbulluara del se në gjithë zonën kanë mbaruar arsimin e lartë mbi 800 vetë. Këtu kanë lindur e rritur, njerëz të përmendur, me kontribute në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe shkencës si: Beqir Ndou, pjesëmarrës në LANÇI dhe zv. Ministër i brendshëm, Filip Meshi, doktor i shkencave veterinare, Kolë Tahiri, profesor doktor i shkencave pedagogjike, Gjin Ndrepepaj, doktor i shkencave mjekësore, Murat Geci, doktor i shkencave pedagogjike, Lush Përpali, doktor i shkencave ekonomike, Ndoc Papekaj, doktor i shkencave albanologjike, Zef Mulaj, doktor i shkencave farmaceutike, Marash Hajati, drejtor i RTSH, Gjin Progni, drejtor i qytetit Studenti, Ndue Ukcama, gazetar e drejtor i departamentit "Bota shqiptare" e lista mund të zgjatet pafund. Frroku më dhuroi librin e tij "Rrugëtim arsimdashës i Tropojës", një libër me vlera studimore e shkencore.

Disa probleme për turizmin

Për nga bukuritë natyrore, Zona e Nikaj-Mërturit, nuk mbetet shumë prapa luginës së Valbonës, Shpatet e thikëta, uji i lumit, si kristali, malet e larta, kanionet e ngushta, pyjet e dendura të gështen-

jave, të shpardhes dhe të bungës, format e larmishme të relievit, bjeshka ku veronjë bagëti, e ku çel lulja përmbi gurë, e bëjnë këtë zonë një bukuri mahnitëse për ta vizituar. Zona e Currajve -Epërm, e Gjonpepajve kanë një bukuri të veçantë. Këtu ndërthuret forma natyrore e relievit me punën e palodhur të njeriut, me ato pak copa tokash të mbjella me pemë e me bimë të shumta që ja shtojnë bukurinë krahinës. Ndonëse rruga përmes liqenit të Fierzës e ka gjallëruar disi lëvizjen e njerëzve, Në Luginën e Nikaj -Mërturit, rrugët nuk mungojnë, bile shkojnë pothuaj në çdo shtëpi, por vetëm deri në qendër të Lekbibajve rruga është e asfaltuar, pjesa tjetër nga zona e Mërturit, rrugët janë të paasfaltuara. që mund të vizitohen vetëm me makina të larta (fuoristrada) Shtëpitë e fshatit shumë pak, kanë nisur të rikonstruktohen, për të pritur turistë. Rruga e pashtruar që ka lidhur dy luginat Valbonën me Nikaj -Mërturin), e ka gjallëruar disi lëvizjen, por vetëm një lokal tek stacionet është disponibël për turistët. Makinat private të transportit jo gjithnjë plotësojnë nevojat e turistëve të kësaj zone, prandaj më e mira është të lëvizësh me mjete të larta personale. Gjithë ajo pasuri natyrore e lënë pas doe. Zona është shpopulluar. Asnjë zile bagëtish, asnjë tufë nuk shihet kësaj zone. Njerëzit duket se janë në dilemë, të pavendosur, nëse do të in-

granohen e do t'i ruajnë trojet e të parëve të tyre, apo do të largohen përfundimisht. Nuk është e lehtë të investosh e të shpenzosh, kur nuk je i bindur se paratë e hedhura do të jenë efikase. Pak parcela arësh janë mbjellë, shumë pak shtëpi duket se janë të vendosura për të qëndruar besnike kësaj zone që ka rritur breza të tërë. Shpresojmë se do të ndjehet dora e pushtetit vendorë dhe qëndrorë, për t'i dhënë gjallërinë e duhur edhe kësaj zone turistike, duke u dhënë më shumë mbështetje për investuesit private.

I dashur Frrok Vukaj,

Të falenderoj publikisht, për iniciativën që more dhe për mikpritjen shumë të ngrohtë dhe miqësore. Falenderoj shumë edhe bashkëshorten tënde, Dilën për shërbimin dhe të na fali mundin e lodhjen për të na krijuar kushte sa më të përshtatshme. Po e mbyllim këtë shkrim, me shpresën se në guidën tjetër, ndryshimet do të jenë të prekshme dhe problemet që ndeshin sot njerëzit për të vizituar këto perla të natyrës shqiptare, do të zgjidhen, me një dorë më të ngrohtë të të gjitha instancave shtetërore që merren me turizmin në Shqipëri. Shumë të fala dhe përgëzimet tona.

Mark Kalaj, Davita Çoku
10 gusht 2021

Historia e familjes ÇEKA (SUMMA)

Epiteti “sumë” ekziston si fjalë e rralë dialektike në folklor dhe ka kuptimin “majë kodre”, ndoshta edhe nga burimi latinisht “majë e lartë” (summa), apo me një kuptim tjetër, kësaj radhe ushtarake, autoriteti komandë e lartë (summa autoritas).

Bajraku i Sumës në zonën e Postribës mund të jetë krijuar para shekullit XVI dhe mbështetet në fillim mbi bazën e lidhjeve të gjakut, duke përfshirë njerëz të një fisi. Udhëheqja e tij i përkiste krerëve të fiseve, ndërsa udhëheqja e forcave ushtarake njerit prej djemve (zakonisht të tretit) të krerëve të fiseve, i cili, si mbajtës i flamurit në ekspedita luftarake, quhej bajraktar (flamur = bajraktar).

Suma ka pasur lagjet e saja si: Gurë-Dajçe, Bukmina, Pergjon, Dedgjon, Vatinikaj, Bojeje, Likaj.

Në listën e anzhuinëve, sado që moshatar me fise të tjera, duke u nisur nga emërtimi latin, fisi i Sumajve u mbajt si i huaj edhe pse në këto shekuj këtij fisi nuk mund t'i mohohet as përkatësia shqiptare dhe as rëndësia historike.

Disa nga fiset e vjetra në Shkodër që gjallërojnë në jetën tonë a në dokumente, janë Logorecët dhe Mazrekët (1304), Sumejt (1322), Muzhanët (1274), Duodaj (1700), Miletaj (1471), Shirokajt etj.

Sumejt kontribuan për ta mbajtur gjallë e zgjuar të fortë idenë e Shqipërisë, madje të një Shqipërie të vetësunduar me forcën e pjekurisë së tyre, me virtytet e racës dhe shëmbëlltyrën perëndimore të një Shqipërie të mëkëmbur, të zhvilluar dhe plot dinjitet.

Shufllaj mbështetet në dokumentet e mesjetës, duke e nxjerrë familjen Suma si familje patriotike nga qyteti i Drishtit (Drivastor-Antica) me kryevend Sumën. Duke filluar nga shekulli i XIV deri më sot, herë direkt, herë indirekt, fisi i Sumajve del me origjinë shqiptare e fisnike nga Drishti.

Në punimet e Prof. Shuteriqit, Dom Nikoll Summa përmendet si ambasador i Gjon Kastriotit në Raguzë.

Me datën 30.12.1378 në Raguzë na del përsëri “Patrus Summa Arbanensis”. Ajo që i vë vulën shqiptarisë së fisit Suma për këtë periudhë është Papa Nikolla V, i cili në 20.09.1451 emëronte Nunc Apostolik françeskanin shqiptar Eugjen Summa.

Pra, në këtë trevë historike bën pjesë dhe aktiviteti i familjes ÇEKA (SUMMA).

Sipas studiuesit shkodran Emil Shiroka, i cili është në fisin e Shirokajve (ku bën pjesë dhe Tina Mikel Çeka, gjyshja jonë), është nxjerrë një material i plotë për historinë e familjes ÇEKA.

Kur turku e pushtoi Shkodrën me kala (jo ku është Shkodra sot, por afër lumit Buna dhe afër liqenit të Shkodrës), shkodranët, burra dhe gra, fëmijë dhe pleq ikën në Itali, ndonjë edhe në malësi, përveç një pasaniku të madh, të cilit Venediku ia kishte ngjitur emrin ÇEKA, që do të thotë “qarë”. Për të mos e humbur gjithë atë pasuri të madhe që kishte, ai e ndërroi besim dhe u bë mysliman. Mbas 5 viteve Veziri i Shkodrës (turk) e detyroi që të shkonte në

Qabe tek varri i Muhamedit për t'u bërë haxhi. Pasi shkoi, ky u bë haxhi dhe erdhi në Shkodër me emrin Haxhi Çeka.

Në këtë kohë ishin dy vëllezër në fshatin Sumë. I madhi quhej Sokol (Kol) dhe tjetri Pjetër. Veziri kishte të dhëna se këta dy vëllezër ishin prej një familjeje të mirë dhe bajraktarë. Dërgoi t'i thërrisnin që të vinin në Shkodër. Pjetri nuk erdhi, ndërsa Sokoli erdhi dhe Veziri i premtoi shumë pasuri dhe tokë, por ai duhej të kthehej në mysliman. Sokoli e pranoi dhe Veziri e mbajti afër vetes së tij. Mbas do kohësh Veziri i tha që të shkonte në fshatin Sumë për t'ia mbushur mendjen Pjetrit dhe



gjithë fshatit që ta mohonin besimin me të mirë ose me detyrim.

Pra, sipas fakteve, rezultoi se nga dy vëllezërit, Pjetri dhe Sokoli, Sokoli e ndërroi besimin dhe u kthye në fenë myslimane. Kjo shihet tek pema gjenealogjike e familjes Summa (Çeka), prej së cilës u nda një degë e saj që quhet Sokolej e fesë myslimane. Dy degë me dy fe kanë një trung të përbashkët, ndaj ne dy familjet ende sot e quajmë njëri-tjetrin kushëri. Në një bisedë me të moshuarin Xhelal Sokoli, ai e kujton nga të parët e tij se Filip Summa (Çeka) e quante e Isuf Sokolin me epitetin “apë”-axhë. Ata të dy ishin nga një trung familjar dhe bashkëlufëtare në kauzën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në fund luftuan së bashku për mbrojtjen e Ulqinit. Edhe ne, si pasardhësit e familjes Suma dhe Sokoli e konsiderojmë veten kushërinj dhe në takimet apo bisedat e ndryshme që kemi midis nesh, thirrëmi me emrin kushëri.

Kur e kuptoi se vëllai i tij Sokoli e kërkonte për ta detyruar që të mohonte besimin me të mirë ose me të keq, Pjetri u arratis nga fshati i tij dhe për 10 vjet qëndroi i fshehur ndër miq të tij në malësi. Pas 10 viteve ai u merrz me jetën e keqe që bënte nëpër male i fshehur, me shumë shpenzime e me rrezik vdekjeje dhe vendosi që të shkonte në Shkodër, drejt e në

shtëpinë e Haxhi Çekës, duke e ditur se ky ka qenë katolik dhe është kthyer në mysliman. Ai i tha se kishte shkuar për t'i rënë në qafë dhe në qoftë se kishte besë ta shpëtonte nga vëllai i tij, Sokoli, i cili donte ta detyronte që ta mohonte fenë, ose përndryshe do ta vriste. Haxhi Çeka i tha që të rrinte tek shtëpia e tij se as kush nuk do ta vriste dhe as besim nuk do të ndërrohte.

Pjetër Summa ndenji tek shtëpia e Haxhi Çekës për 3 vjet dhe mbas kësaj Haxhi Çeka i dha para për të bërë një shtëpi (ose më mirë një jerevi). Pjetri e ndërtoi shtëpinë por kur turqit e morën

Ndër lëkurat që shiste, ato të lepujve nuk kishin asnjë vlerë, ndaj tregtarëve iu mbetën pa iu shitur për 5 vjet, duke i mbushur magazinat plot me lëkura lepujsh. Këta tregtarë nuk ishin vetëm shkodranë, por edhe prej qyteteve të tjera. Hila u propozoi tregtarëve që t'ia shisnin me kredi dhe çmim të lirë për një vit. Tregtarët e lëkurave mbetën të kënaqur nga kjo marrëveshje me Hil Sumën (Çeka).

Vëllai i madh, Preçi, ishte në kundërshtim me këtë marrëveshje dhe thoshte se brenda vitit tregtarët do t'i kërkonin paratë dhe nuk do të kishin mundësi të paguanin. Ata do t'ia merrnin shtëpinë,

e cila nuk kushtonte më shumë se 6 qese dhe prapë se prapë do t'i mbeteshin borxh tregtarëve, mbasi lëkurat nuk kishin se ku të shiteshin. Atëherë Hila mori një barkë me qira, e mbushi plot me lëkura dhe u nis për Venedik. Mbas 3 muajve ai u shkroi vëllezërve se lëkurat nuk po i shiteshin sepse nuk kishin asnjë vlerë, por po vazhdonte të rrinte atje, se ndoshta gjente ndonjë tregtar dhe i shiste. Mbas disa muajve Hila u tregoi vëllezërve se u kishte dhënë tregtarëve nga 1 grosh e gjysmë për copë, por shton se nuk po ngutej që t'i shiste se ndoshta mund t'i jepte me një çmim më të lartë. Tre vëllezërit vazhdonin punën si rrobaqepës, por ishin në merak për Hilën dhe për paratë që u duheshin dhënë tregtarëve të lëkurave.

Në Shqipëri Hila i bleu lëkurat me 4 pare copën dhe tregtarët e Venedikut ia dhanë

me 60 pare copën, prandaj vëllezërit u çuditën pse Hila nuk po i shiste. Në ato kohë nuk kishte as port, as vapor, veç kur vinte ndonjë barkë për disa muaj. Kur u mbushën tetë muaj Hila ishte në Venedik dhe i lajmëroi vëllezërit që lëkurat e lepujve i kishte shitur për 120 pare copën dhe duhej ta mbanin sekret si dhe të blinin tetë dyqane në rrugën e hekurit që ta shiste mallin që kishte sjellë me barkë.

U blenë 6 dyqane dhe 2 u morën me qira. Mbasi u mbush viti, Hila erdhi nga Venediku me barkat plot e përplot me mallra si, manifakturë koloniale, lëkura etj., dhe bashkë me vëllezërit i rregulloi të gjitha nëpër dyqane. Nuk kaloi shumë kohë dhe erdhën tregtarët me lëkura, dylle etj. Hila ua bleu të gjitha lëkurat, dyllin dhe llogaritën edhe lëkurat e lepujve që i kishin dhënë në besim një vit më parë. Hila u propozoi tregtarëve që të blinin mall, të cilat i jepte edhe me kredi, duke u thënë se atyre që e kanë besuar për 10 qese, ai do t'i besonte për 100 qese. Kështu tregtarët u nisën të kënaqur si për shitje ashtu dhe për blerje.

Mbasi puna erdhi duke u shtuar, Hila u detyrua që të hapte agjenci në Prizren, Gjakovë, Tetovë etj. Ata dërgonin shërgertë nga Shkodra tek ato agjenci, të cilat njiheshin të firmës Summa (Çeka).



PËR TË PAREN HERË NË ZEMËR TË EVROPËS, XHUBLETA DHE FUSTANELLA PERFORMOJNË BASHKË, ME DINJITET SI SHQIPJA DYKRENARE MBI FLAMURIN E NJOMUR ME GJAKUN E BIJVE TË VET

Të mirë menduar dhe largpamëse do ta quaj ftesën e personalizuar ndaj Shoqatës Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” dhe Grupit Polifonik “Bilbili” i Labërisë, nga Shoqata Atdhetare “Nënë Tereza” me qendër në Belgjikë, si dhe nga vetë organizatorët e aktivitetit z. Arian Bajraktari dhe z. Adnan Rexhepi kushtuar Festës së Pavarsisë së Shqipërisë dhe datëlindjes së Legjendarit Adem Jashari të përgjatsuar në Altarin e Lirisë. E lidhur kjo me faktin se prezenca e këtyre dy identiteteve të lashta shqiptare, “Gegë” & “Toskë” në këtë aktivitet, ishte një risi kulturore e shpalosur për herë të parë në skenën e Teatrit Mbretëror të Belgjikës në qendër të qytetit të Namurit. Veç kësaj edhe për faktin se Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) gjendet fare pranë kësaj godine kuptimplote tek e cila, aktualisht, në vëmendjen e saj ka zënë vënd edhe dosja me jetëshkrimin e rëndësisë dhe vlerave unike që mbart XHUBLETA, pasuria më e çmuar i identitetit shqiptar që e peshon dhe dëshifron këtë identitetin kombëtar me prezencën dhe të folurën e saj të lashtë sa vetë jeta, në gjuhën gego - pellazge. Dhe, si thotë një fjale e urtë “asgjë nuk ndodh pa një arsye”, pasi ishte pikërisht kënga isopolifonike e Bilbilave të Labërisë, tashmë e mbrojtur nga UNESCO, e cila e shoqëroi drejt Belgjikës këtë Identitet Kulturor për të dëshmuar në sy të Europës unitetin vllazëror që i karakterizon shqiptarët anë e mbanë botës, pavarsisht se cilës anë të Shkumbinit u përkasin rrënjët e tyre gjenetike. Dhe jo për modesti, por edhe për krenari ky aktivitet kulturor shpalosi hijshëm edhe unitetin shqiptar ndërkuftar, ku si asnjëherë tjetër u pa kujdesi dhe kontributi i secilit në realizimin

e kësaj veprimtarie soleme, ku merita e këtij suksesi nuk veçoi të parë as të fundit, pavarsisht se përgjegjësia binte direkt mbi

organizatorët. Na gëzoi fakti se në ato ditë të pakta nëntori patëm fatin të njohim shumë qytetar të atij komuniteti Belg që vinin nga treva të ndryshme të trojeve etnike shqiptare, të cilët e sfiduan të ftohtin natyror dhe na ngrohën me dashamirsinë e shprehur me përzemërsi në gjuhën

vërtetë krenar për shqiptarët me banim në Namur të Belgjikës, e jo vetëm, të cilët me ambicje të madhe po bëjnë epokë sukcesi në sytë e botës së kulturuar. Ky fakt na jep edhe më shumë krenari pasi ata janë dhe mbeten për kulturat e huaja pasqyra jonë e lexueshme, se kush janë në të

sa të lejojë aktivitete për qëllime kulturore, juridike apo të ofrojë edhe ndihma humanitare për nevoja me bazë materjale në disa qendra komunitare në Shqipëri e më gjërë, sikurse ishte rasti i zjarrfikseve dhe mjeteve spitalore të dhuruara Bashkisë së Malësisë së Madhe. Mjaftuan ato



pak orë pas aktivitetit për të krijuar një frymë gjallërie nën tingujt e çiftelisë, lavdës dhe isopolifonisë në ambjentet e Bar - Restorant Metropol të Cem Umit dhe bashkëshortes së tij Arta Umi, të cilët veç bujarisë dhe milkpritjes së tyre përgjatë gjithë qëndrimit tonë, në darkën e shtruar për këtë rast me të gjithë të ftuarit ky ambjen mori kuptim të vërtetë festiv me këngë dhe valle shqiptare, të cilat pasonin njëra-tjetërën si shtregullat e dasmave motit natën e dasmorëve, sepse e tillë u bë edhe kjo natë festive në zemër të Belgjikës me harmoninë e këngëve të ladës së çakçirëve dhe xhubletës me isopolifoninë e fustanellës. Namur - Belgjikë 2021

**Shkruar nga Rita Shkurtaj,
Namur - Belgjikë 2021**

◀ Simoni ishte më i vogli ndër vëllezër dhe dinte shkrim e këndim dhe në llogari ishte mjaft i zoti. Këtij ia lanë të gjitha llogaritë si dhe korrespondencën e shitjes së mallit dhe kontrollin e të gjitha agjencive që kishin. Ai shkante të ngarkonte nga 20-30 kuaj me pare dhe i sillte në Shkodër. Hila udhëtonte në Venedik, dërgonte lëkura të ndryshme të regjura, dyllë e bletë, i shiste atje dhe kthehej me mall të ndryshëm për Shkodër.

Preçi dhe Kola ndenjën gjithmonë në Shkodër, blenë toka, vreshta, dyqane dhe u martuan sipas radhës. Hila ndërtoi një shtëpi të madhe me 6 dhoma, e cila sot thirret Arra e Madhe. Kur e panë atë shtë-

pi, populli tha se Hil Çeka kishte ndërtoar një kala.

Preçi pati 2 djem: Pjetrin dhe Zefin. Pjetri pati 3 djem: Ndocin, Filipin dhe Mikelin. Ndoci pati 2 djem: Pjetrin dhe Lecin. Ky i fundit pati 2 djem: Tonin dhe Pjetrin. Zefi pati Ejllin, i cili la 9 fëmijë: një djalë, Gasprin dhe 8 vajza. Gaspri pati 3 djem: Ejllin, Zefin dhe Luigjin. Këta nuk u martuan, ndaj kjo degë u shua.

Tetë vajzat e Ejllit ishin: Çilja, Agia, Kusha, Drandja, Cina, Tonja, Lezja dhe Gjystja. Çilja dhe Agia u martuan me bijtë e Pjetër Shirokës, Shanin (1837) dhe Gasprin (1834). Kusha dhe Drandja u martuan me bijtë e Kol Shirokës, Ndreken (1834) dhe Zefin (1837). Cina u martua

vërtetë shqiptarët. Ndoshta kjo është edhe arsyeja përse paria e Komunës së Namurit i ka me sy të mirë qytetarët shqiptar

me Pashko Muzhanin, Lezja me Loro Saraçin, Tonja me Filip Çurçinë dhe Gjystja u bë murgeshë.

Kola la një djalë, Filipin, i cili pati vetëm vajza dhe kjo degë u shua. Simoni, më i vogli, ka 5 djem: Matinë, Lazrin, Ndocin, Franon dhe Gasprin. Matia vdiq, Lazri shkoi në Francë dhe Franoja shkoi në Spanjë. Por për ta nuk kemi asnjë informacion. Ndoci pati vajza e kjo degë u shua gjithashtu, ndërsa Gaspri pati Kolën, i cili la Zefin me dy djem, Nikolinin dhe Gasprin.

Materiali për familjen Çeka është edhe në Arkivin Qendror të Shtetit Tiranë, dorëshkrim.

Filip Çeka (Summa), i cili pas vdekjes, është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me urdhrin “Kalorësi i urdhrit të Flamurit”, me datën 26 janar 2022, me motivacion: “Në shenjë vlerësimi për veprimtarinë e tij atdhetare e si anëtar i Lidhjes së Prizrenit, i shquar për rolin e tij luftarak në mbrojtje të Plavës e Gucisë, si dhe një nga nënshkruesit e telegramit të dërguar Kongresit të Berlinit për moscopëtimin e trojeve shqiptare”

Vijon në numrin ardhshëm

Përgatitur nga Engjëll Çeka

NJË “DHURATË” E ÇMUAR PËR TROPOJËN

Ka kohë që qarkullon libri i Frrok Vukajt “Rrugëtim arsimdashës i Tropojës”. Frroku është një nga filizët e Nikaj- Mërturit (Shëngjergj), ndër intelektualët e tij, mësuesi, drejtuesi, studiuesi, hulumtuesi i vlerave shpirtore të kësaj zone. Ai në këtë libër dha një pjesë të shpirtit të tij, duke e parë relitetin në sy, me optimizëm, larg politizimit, larg servilizmit, duke analizuar e vlerësuar me syrin e specialistit edhe arritjet e sukseset, edhe mangësitë e kufizimet. Ai nuk e fsheh qëndrimin e tij, nuk stepet e nuk heziton, nuk rrudhet e nuk tkurret, për të thënë realitetin. Ai këtu ka derdhur talentin e tij profesional, ka shprehur dufin e zemrës, inteligjencën e aftësitë e tij, përvojën gjysëmshkullore në edukimin e brezit të ri. Ai arriti ta shohë shkollën e Mesme të Bashkuar Lekbibaj, në të cilën drejtoi për një kohë të gjatë, në shkollat më të dalluara të rrethit, dhe e dekoruar nga Kuvendi Popullor, me 7 Mars 1987. Në libër janë pasqyruar me realizëm puna me përkushtim e mësuesve dhe nxënësve, ndihmesa e pashembullt e prindërve. Për pasqyrimin e kësaj pune titanike, e kanë ndihmuar dhuntitë metodike, burrëria e bujaria që i ka trashëguar nga prindërit, forca dhe karakteri i tij i pashoq, trimëria e guximi, me të cilat çau përpara me krenari. Puna e tij sistematike e këmbëngulëse, gërmimi në arkivat dhe në materialet studimore, shfrytëzimi i ditareve e shënimeve të mbajtura në vite, përvoja e grumbulluar në punë, janë baza e këtij libri shkencor, profesional, të punuar me aq dashuri e ndjesi, për t’ua lënë brezave. Përfshirja e historikut për gjithë rrethin e Tropojës dhe ndërthurja e kësaj pune me vendimet e direktivat e Qeverive, i ka rritur këtij libri karakterin shkencor dhe gjithëpërfshirës.

Frroku, këtë libër ua “dhuron” njerëzve të tij të dashur që i pati krah dhe e kanë frymëzuar gjithnjë, por dhe kolegëve të një llogorje të përbashkët, miqve dhe dashamirëve, fshatarëve të tij të dashur që megjithëse është shkëputur prej tyre prej shumë vitesh, i duket se është pjesë e pandarë e trupit, e dëshirave, bujarisë, respektit, trimërisë, vendosmërisë, inteligjencës.

Pak nga brendia e librit:

Libri është konceptuar në katër kapituj:

1. **Fara e dijes**, në të cilën autori i mëshon shumë fuqishëm aktorëve dhe faktorëve të rëndësishëm që ndikuan në përparimin dhe dijen ku rol të veçantë luajtën familja dhe feja si pjesë e superstrukturës;

2. **Nga masivizimi në rritje cilësore** (1945-1990);

3. **Tranzicioni dhe shkolla**, ku përfshihen jo vetëm probleme të ndryshimit të sistemit, por edhe të rejtat që lindën bashkë me sistemin e ri demokratik, ku janë analizuar me hollësi.

4. **Kapitulli ilustrues** i paisur me literaturën mbi të cilën është mbështetur autori për përpilimin e këtij libri si dhe fotografi.

Vlerësimet:

Në libër vlerësohen përpjekjet e vazhdueshme titanike të popullit të kësaj treve për arsim e dituri, të bëra në periudha të ndryshme historike. Tradita në edukim, odat e burrave dhe kuvendet e malësisë, kanë dhënë një ndihmesë të madhe. Sh-

embull për t’u ndjekur kanë qenë titanët e mendimit popullor të krahinës si: **Binak Alia, Nikë Mengja, Balc Gjoni, Tunxh Miftari, Sali Mani, Hoxhë Dollapi, Gani Sokoli** etj. Natyra fantastike dhe format e relievit, cicërimat e zogjve, e britmat e kafshëve të egra, gurgullima e përrënje, vërshëllimat e erës, u pasqyruan në krijimtarinë e njerëzve të kësaj treve.

Tropoja bënte pjesë në **Dioqezën e Pultit** e themeluar që në vitin 877. **Kuvendet e fretërve** në **Gash** (1649), në **Toplanë** (1696), në **Mërtur** (1705), kishat e **Shën Premtes** në **Tetaj** (shek 13), famullia e **Nikajt në Gjonpepaj** më 1779, në **Curraj të Epërm** 1897, pa mohuar shërbimin për ruajtjen e kultivimin e fesë, kanë shërbyer si vatra edukimi për ruajtjen e vlerave kombëtare, të zakoneve dhe traditave të popullit tonë: gjuha e pastër, doket, këngët, vallet, tregimet, legendat, veshjen, veglat muzikore, bujarinë, trimërinë, heroizmin, mësimn dhe edukimin e njerëzve dhe i kanë pasqyruar në ditaret e tyre. Nga dokumentat del se që në vitin 1638, në **Gash të Tropojës** u bë mësim dhe **predikim shqip**.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, me kërkesa të vazhdueshme të popullit dhe pas këmbënguljes së Drejtorit të Përgjithshëm të Arsimit z. **Luigj Gurakuqi**, me 1 qershor 1917, hapet shkolla e parë në **Gjonpepaj**, me mësues famullitarin **Atë Nikoll Kolaj**. Pak më vonë (1918), hapet shkolla tjetër në **Raja të Mërturit** dhe në **Malësinë e Gjakovës**, në **Bujan**, me 04.01.1923 me 40 nxënës, me mësues **Osman Shaqirin**. Rëndësi pati hapja e internatit “**Kosova**” më 1923 në **Kolgecaj** (Bajram Curr). Pas tyre vijuan shkollat në **Palc, Shëngjergj, Degë, Curraj i Epërm** etj. Shkollat u hapën e u mbyllën disa herë gjatë atyre viteve, por ato janë të parat dallëndyshe të arsimit në zonën e Tropojës dhe shërbyen për shkolimin e fëmijëve të kësaj zone të thellë.

Një vënd të veçantë zen arsimit pas Çlirimit. Hapja e 5 shkollave fillore në vitin 1946 në **Selimaj, Llugaj (Rrogam), Berishë, Salcë Gjonpepaj** dhe e kurseve kundër analfabetizimit, u bënë një bazë e shëndoshë për arsimimin e zonës së Tropojës, ku u dalluan mësuesët: **Shaqe Sokolja, Qerim Alia, Osman Hoxha, Ndue Kola, Vlash Gurashi, Burhan Hoti** dhe dhjetra të tjerë. Përgatitja e mësuesve vendas krijoi mundësitë e hapjes së shkollave 7 e 8-vjeçare në **fshatin Kolgecaj** më 1948, në **Tropojën e vjetër** (1949), në **Babinë** më (1950), në **Buçaj** (1952), **Gjonpepaj** (1953), **Geghy-sen** (1953), **Kovaç (Kërrnjë)** (1953), **Shëngjergj** (1960), **Salcë** (1964), **Curraj i Epërm** (1966), në **Q.Mulaj** (1975), **Bricë** (1977), **Tetaj** (1982), ku u dalluan drejtuesit e shkollave: **Zef Doda, Lazër Martinaj, Gjokë Doshi, Ndue Doshi etj.** Pas viteve 1975 u hapën edhe shumë shkolla të tjera 8-vjeçare në **Qeresh-Mulaj** (1975), **Bradoznicë** (1976), **Kovaç** (1976), **Markaj** (1979), **Luzhë** (1981), **Tetaj** (1982) etj. Në vitin 1975, numri i nxënësve në të gjitha hallkat, brenda dhe jasht rrethit deklarohet në **10 000**, rritur 2,5 herë krahasuar me 10 vite më parë. Në jetën e shkollës së kësaj zone ndikuan hapja e **Konviktit të Xhanit**, në vi-

tin 1946, që një vit më vonë u transferua në **Theth**, dhe më 1953 konvikti pranë shkollës 7-vjeçare **Kolgecaj**, në të cilin u strehuan mbi 100 konviktorë nga Tropoja.

Hapja e shkollës së mesme bujqësore në shtator të vitit 1970, në **Tropojë**, ish qendër e rrethit, ishte ngjarje me rëndësi. Në fillim të viteve 70, në qendër të rrethit kanë funksionuar edhe shkolla e mesme e mamive, shkolla ekonomike dhe industriale shumëdegëshe në **Fierzë** (1972). Një ngjarje e veçantë ishte hapja e shkollës së mesme bujqësore në **Gjonpepaj**, në shtator të vitit 1976 dhe e një dege të arsimit të mesëm të përgjithshëm në vitin 1985, në të cilat kanë marrë dëftesa mbi 2000 nxënës dhe kanë mbaruar arsimin e lartë mbi



150 prej tyre. Në vitin 1976 u hapën edhe tre shkolla të tjera të mesme bujqësore: në **Llugaj, Bujan e Pac** dhe në vitin 1983-1985 edhe shkollat e mesme në **Cërnicë, Babinë Margegaj** etj. Në vitin shkollor 1999-2000, në rrethin e Tropojës kishte 20 kopshte të edukimit parashkollor, 45 shkolla 8-vjeçare, 35 shkolla fillore vartëse, 11 shkolla të mesme. Nga këto shkolla vazhduan arsimin e lartë dhe janë diplomuar mbi 800 quadro të lartë vendës.

Pas viteve 1990, në kapitullin tranzicioni dhe shkolla, autori është ndalë në problemet me të cilat u përball zona: me lëvizjet masive të popullsisë dhe me uljen drastike të numrit të nxënësve e me largimin masiv të mësuesve me arsim përkatës. Në vitin shkollor 2014-2015 në Zonën e Nikaj-Mërturit funksiononin vetëm shkolla e mesme **Lekbibaj** me 140 nxënës, shkolla 9-vjeçare **Gjonpepaj** me 83 nxënës dhe shkolla 9-vjeçare **Shëngjergj** me 39 nxënës. Janë mbajtur ende shkollat e c.ulët në fshatrat **Tetaj, Mserr, Palc, Salcë, Bricë**, por në dsa prej tyre me mësues pa arsim përkatës. Autori ven në dukje disa arritje të shkollës së këtyre viteve si depolitizimi, hapja e arsimit privat, evoluimi i metodave të mësimdhënies e mësimnxënies, altermteksti etj, por është ndalur në dukuri negative që ndikojnë në cilësinë e punës së shkollës si: Krijimi i klasave kolektive në ciklin e lartë, mungesa e arsimit privat në Tropojë, mungesa e mësuesve të kualifikuar në zonat e thella, gjakmarrja dhe ngujimi i nxënësve, stresi dhe ndikimi në rezultatet e shkollës, etj. Autori është përpjekur dhe ka dhënë eksperiencën e tij dis-avjeçare në punën me nxënës, për të gjetur burimet e stresit dhe për të dhënë forma të përballimit të tij. Është ndalë veçanërisht në kurrikulën dhe shkollën, në ngarkesën mësimore dhe format e shmangies së mb-

ingarkesës. Ai është ndalë në altermtekstin, në problemet që dalin me maturën shtetërore, metodat e mësimdhënies dhe metodat me qendër nxënësin, vlerësimi dhe vetëvlerësimi, puna me kuadrin, roli i drejtuesit në shkollë dhe probleme të tjera që vlerësojnë punën e palodhur të qindra mësuesve vendës dhe të ardhur nga rrethet e dalluara në arsim dhe kulturë. Këtu ka lista të plota të autoriteteve shkencore të rrethit, doktorë shkencash dhe profesorë, lista të mësuesve sipas profileve, lista të kuadrove të dalluar në kulturë, të dalluar në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, në shëndetësi e kudo kanë dhënë kontributin e tyre të vyer. Libri shoqërohet në vend të parathënies nga dy shkrime të **Prof. Dr Musa Krajës** dhe të **Mujë Buçpapajt**, të cilët vlerësojnë nga ana shkencore, rëndësinë e këtij punimi dhe rëndësinë e tij jo vetëm për Tropojën por për gjithë Shqipërinë. Libri ka edhe sentenca nga njerëz të shquar të artit dhe kulturës për arsimin. Është i paisur me shifra e fakte për numrin e nxënësve e të mësuesve në vite, me tabela për listën e mësuesve të shkollave, të mësuesve me arsim të lartë sipas specialiteteve, të nxënësve konviktorë në vite, të njerëzve të shquar të shkencës dhe të artit që kanë dalë nga shkollat e kësaj treve, doktorë në degë të ndryshme të shkencave, profesorë e doktorë me tituj që kanë dhënë kontributin e tyre të padiskutueshëm në zhvillimin e arsimit dhe kulturës në vend e jashtë vendit. Ai për çdo kapitull ka përcaktuar arritjet më të rëndësishme dhe është përpjekur të japë edhe problemet për të cilat kërkohet zgjidhje dhe mënyrat e zgjidhjes.

Në mbyllje të këtij libri, autori shkruan: “**Gëzohem e ngazëllem, për sukseset e arritura në të katër anët e Shqipërisë e më gjërë, për kontributet e sukseset e tropojanëve, bashkudhëtarë e pjes-marrës të zhvillimeve transformuese të cilët arsimohen e punojnë me qytetari për një jetesë më të mirë. Me modesti dhe pa vetëburrje, duhet pohuar se mundësitë dhe energjitë e tyre, janë të pashtershme dhe faktor i rëndësishëm i përparimit**”.

Libri ka një gjuhë të zgjedhur e të përshtatshme për çdo lloj moshe e për të gjitha shtresat, është i këndshëm dhe tërheqës dhe tregon për një punë të gjatë në vite dhe nuk është një “Udhëtim i rastit”, por një ndalesë e thelluar në historikun e arsimit të Tropojës, i lidhur ngushtë me historinë e shkollës shqiptare, me evenimentet e saj më të rëndësishme dhe është i bazuar në dokumente historikë të besueshëm. Ky libër i shkruar me kompetencë, ka vënë një gur themeli në arkivin e Arsimit e kulturës në zonën së Tropojës dhe nuk duhet t’u mungojë bibliotekave tona.

Libri është paisur me foto të mësuesve, shkollave dhe veprimtaritë shkollore e kulturore në rrethin e Tropojës. Është rezervuar një vend i veçantë për nxitësit e sponsorët, zotërinjtë **Kadri Basha** dhe **Gjin Niklekaj**, të cilët edhe ne i falenderojmë që kanë bërë të mundur botimin e këtij libri. Libri përmban një punë voluminoze të autorit të cilin e falenderojmë dhe e inkurajojmë për punë të tjera të tilla që i shërbejnë jo vetëm vendlindjes së tij, por edhe gjithë arsimit në tërësi.

SI TË FORCOJMË SISTEMIN TONË IMUNITAR-MBROJTËS

Eksperiencia e Pandemisë Covid-19 (SARS-Cov-2) na mësoi mirë, se disa persona infektohen duke vuajtur pak dhe disa të tjerë vuajnë jashtë mase, duke përfunduar fatkeqësisht me vdekje, pavarësisht mjekimit intensiv të specializuar. Të moshuarit- senjoret janë goditur më ashpër, por disa arritën të mbijetojnë, që llogariten me qindra. Të rinjtë, ku sistemi imunitar- mbrojtës është më i forte, ata kane qene më rezistent, por sidoqoftë ka pasur dhe raste të renda, pavarësisht moshës së tyre. Behet pyetja, perse disa kane forca mbrojtëse për ta tejkaluar e disa jo? Çfarë duhet të kuptojmë me faktin, që bashkëshorti ose femija juaj sëmuret e ju jo, ose anasjelltas? Ne dimë se sistemi imunitar- mbrojtës me moshën gradualisht zvogëlohet (ulet) nëse ju krahasoni një foto tuajën të sotme me atë të para 10 vjetëve, do të vëreni dallimin në fytyrë, të lëkurës dhe të ngjyrës së flokëve. Ndryshimi ka qene i ngadalshëm, është ajo çka arrin dhe në sistemin imunitar- mbrojtës, thekson Dr. Insoo Kang- Immunolog në Universitetin- Yale. Përmirësoni energjitë tuaja- Kang studioi plakjen njerëzore, për 20 vjet një gjini e leukociteve. Qelizat imunitare ndryshojnë me kalimin e kohës si leukocitet T-CD8. Mirëpo, trupi ka nevojë për to, për të njohur mikro-organizmat e rinjsi në rastin e Coronavirusit-SARS-cov-2 (Covid-19), që përfshiu gjithë botën, sido që jo me të njëjtën shpejtësi. Shkenca nuk arriti të shpjegojë perse ndryshoi ritmi nga një subjekt në tjetrin. Sistemi imunitar- mbrojtës është kompleks, por u kuptua nga të gjithë esencjalja, organizmi e zbulon një instrus (agresor të jashtëm), virus, bakterie, parazit, trup të huaj etj. dhe fabrikon leukocite dhe organizon izolimin dhe shkatërrimin (zhdukjen) e tyre. Por si... i prodhon, një 73 vjeçar dhe si një 45 vjeçar? Çështje e cila është në qendër të vëmendjes në këtë pandemi të Covid-19, ku një burrë 104 vjeç pati mundësi të mbijetojë ndërkohë që, pacient të tjerë sa gjysma e moshës së tij ose më të rinj cedojnë, "kane vdekur". (Përgjigjja imune është e ndryshme për persona të ndryshëm)....


Fatmirësisht pandemitë nuk zgjasin pafundësisht. Ne do të kemi interes të kuptojmë më mirë se si degradon sistemi ynë imunitar- mbrojtës me moshën dhe kështu të gjejmë mjete të mundshme të frenojmë dhe ta forcojmë rezervat tona imunitare duke pritur agresionin e ardhshëm.

IMUNITETI dhe pleqëria-Trupi ynë nuk prodhon aq thjeshte qeliza imunitare, se me kalimin e moshës konstatojnë Atul Butte, Profesor epidemiolog dhe i abiostatikës Universiteti i Kalifornisë në San Francisco, askush nuk e din perse? Atul Butte dhe një ekip kërkuesish bënë një meth-analize të 242 studimeve, mbi imunitetin, që hodhi drite mbi disa faza të evolucionit në kohe. Qeliza imunitare kyçe limfocitet-B (leukocite që prodhojnë antikoopre dhe luftojnë infeksionin) dhe limfocite -T (leukocite që godasin viruset), që bëhen më të pakta në numër. Ne kemi p.sh dy kategori limfocitesh "T", ato që quhen me "memorie", nga ato që janë takuar me një invadus (armik) dhe

që thirren për të luftuar dhe ato "naiv" si T- CD8, që nuk janë aktivizuar në asnjë fushatë lufte. Ne kemi vënë re se, numri i këtyre qelizave naive tenton të ulet me kalimin e viteve (me moshën) thekson Atul Butte.

Disa këshilla të papritura e të padëgjura mbi Rrufen.

Dihet se si virusi i Covid-19 (SARS-cov-2} u shfaq. Asgjë për te nuk kishte takuar as njohur eksperiencia humane deri tani dhe asgjë nuk përngjante. Pra, ne nuk mund të aktivizojmë asnjë leukocit-



T" në memorie, sido që disa studime-kërkime më të fundit na bëjnë të mendojmë se disa mes tyre mund të zhvillojnë një mbrojtje të pjesshme nga që kane luftuar më pare kundër një tjetër Coronavirusi. Këto janë qelizat "naive" që do të përbëjnë një fare përballje. Të moshuarit kane pak mundësi. Ato janë më të prekshëm, por jo gjithnjë, ngaqë sistemi imunitar- mbrojtës nuk dobësohet me një shpejtësi uniforme. Methanaliza e Dr. Butte vlerësoi mes tjerash, se subjektet e moshuar me shëndet të mirë, kishin thajse të njëjtën sasi të limfociteve -"T" sa të rinjtë, dhe nga e kundërta gratë, duke u plakur rezervojnë më shumë qeliza mbrojtëse se sa burrat. Por askush nuk e din deri më sot se sa limfocite-B dhe T -duhen për të qene me shëndet të mire. Kur bëjmë një analize gjaku ordinere, njihet numri normal i rruazave të kuqe, i leukociteve, ose niveli i hekurit, i hemoglobinës, por nuk kemi as idenë më të vogël për të tjerat, thekson M. Butte. Shkaqet e uljes së këtyre qelizave jetësore mund të jene të shumta: Trashëgimia? Mënyra e jetesës?

- Ne dimë se trashëgimia luan një rol, por rëndësia e saj është mjaft e diskutueshme, në raport me ndikimin e ambientit dhe të mënyrës së jetesës. Mungesa e gjumit, stresi i zgjatur në kohë dhe mbipeshja provokojnë shpesh një inflamacion të zgjatur-kronik, do të ketë turbullime sistemike si tek sëmundjet autoimmune dhe dy funksioni hepatit dhe renal. Ketë inflamacion e detyron sistemi autoimun, duke ndervepruar pa ndërprerë, duke turbulluar funksionet e tij. Pasojat- një plakje e shënuar e qelizave që mund të induktojnë një sëmundje zemre, diabet tip-2, sëmundje Alzheimer me humbje kujtese dhe shumë probleme të tjera, duke fragjilizu, dobësuar imunitetin- (mbrojtjen) pa kufi.

Shume funksione organike janë të rregulluara në mënyrë strikte, thekson Dr. Sean Xhiao Leng Geriater-në "Universitetin Johns Hopchis". Sistemi imunitar nuk bën përjashtim dhe pse çrregullimi

është i rrezikshëm. Ne nuk mund të ndryshojmë trashëgiminë tone, por ne duhet të veprojmë për mirë me një numër faktorësh për të forcuar sistemin imunitar- mbrojtës. Merreni seriozisht thekson. Dr. Leng. Ju nuk mund të pengoni imunitetin të dobësohet me kohën, por një ngadalësim i këtij procesi ju do tu siguroj mjete të mbrojtjes suplementare në gjithë moshat. Është kritike përballimi infeksioneve.

Prekja e të moshuarve ka dy përbërës, precizon Leng. Së pari, incidenca, bën që të sëmuremi ose jo. Së dyti, graviteti (rëndesa) po ashtu nuk evitohet infeksioni,

një sistem imunitar më i forte, mund të qetësoj gravitetin. Me fjale të tjera- parandalimi është kryesor. Dhe mbështetuni në sa vijon: Lëvizni—aktiviteti, ushtruara e rregullt stimulon funksionin imunitar. Një studim i publikuar në vitin 2019, në "Natyra"-rënies Immunology" afirmon se muskulatura skeletike, është një organ i rregullimit imunitar" e quajtura Myokinin. Po ashtu dhe ushqyerja e rregullt dhe e pasur në proteina dhe vitamina e ingredient përmirëson mbrojtjen imunitare. Po ashtu, ushtrimet forcojnë trupin dhe jep mundësi të forcohet në tersi organizmi thekson M. Kang.

Si të tonizojmë trurin tone? Për të njohur gjendjen e shëndetit Atul Butte këshillon pacientet të bëjnë një bilanc shëndetësor- "si Check-Up"- për tu orientuar. P.sh-Astmatiket të bëjnë provat funksionale respiratorë dhe testin alergjik, për të pasur një ide mbi aftësinë e mushkërive. Dhe në se debiti respirator bie 8%, ndiqeni nga afër evolucionin dhe konsultojuni me specialistet përkatës, e të zgjidhet mjekimi më i mirë për penguar degradimin. Ushqyerja e shëndetshme dhe evitimi i (dhjamosjes) obezitetit-si një faktor mortal (vdekjeprurës). Kërkimet kane vërtetuar se ushqyerja ka efekt specifik në personat e moshuar. Në "Nutrients" 2018 është vërtetu se si vitaminat A, C, D, E dhe kompleksi- B, acidi Folik, hekur i(-Fe-), seleniumi dhe Zinku kontribuojnë shumë në "Imunokompetence"-në mungese të tyre prodhimi i limfociteve"-T" ulet, kështu organizmi është i pa afte të luftoje inflamacionin. Pra, kyçi është të mbahet ekuilibri sipas Dr. Kang. Hani jo vetëm perime e fruta, por dhe proteina të shëndetshme dhe fibra, sepse zhvillojnë bakteret e mira në zorrë dhe lehtësohet inflamacioni. Në zorrë ka shumë qeliza imunitare, që ndihmojnë rregullimin organik, fibrat ushqimore ka mundësi të kenë reaksion imunitar të zgjatur dhe shpërthen një efekt në lëvizjet peristaltike të zorrëve dhe në bakteret e mira saprofitë. Qetësojuni -Stresi -shpërthen një reaksion imunitar kronik dhe rëndon inflamacionin-merreni nën kujdes, duke praktikuar relaxant-meditim, ushtrime etj. dhe me çdo mënyrë të rregullohet, që të mos përjetohet stres as në punë, as në shtëpi, stresi ka mjaft ndikim mbi imunitetin-hiqni dorë nga duhani, lëreni me çdo kusht -censi i suksesit është ekuilibri- thekson Dr. Kang. Mësimet e

Covid-19-Pandemia e SARS-Cov-2 (Covid-19) na mësoi të lajme e të dezinfektojmë duart shpesh, gjate ditës të mbajmë maska e doreza, të mbajmë radhët në distance 2 metra, dhe izolim i të moshuarve që goditen më lehte nga imuniteti i pakësuar.

Dr. Butte mendon se jemi në një erë të re të imunologjis, ne po mësojmë shumë më shpejt. Dr. Leng parasheh një sforcë të madhe, për të kuptuar më mirë pasojat imunitare të të moshuarve, bazuar në studimet e popullsisë së moshuar dhe zbulimin e mekanizmave imunitare të pa njohura akoma. Modeli mjekësor klasik është pakësuar mbi sëmundjen, do tentohet të dihet nëse ekziston një mekanizëm imunitar i lidhur me te -nëse po, ne do të mund të realizojmë kërkimet, që tejkalojnë sëmundjet specifike. Nëse e arrijmë, personat e moshuar do të jenë më mirë të armatosur për të përballuar kërcënimet kundër imunitetit të ulur.

Sistemi ynë imunitar a është fraxhil?

Disa afeksione mund të bëjnë sistemin tonë imun me pak të afte të luftoj me viruset. Nëse ju e keni diagnostikuar, një nga problemet vijues, bëni çfarë të keni mundësi, për të forcuar mbrojtjen dhe kërkoni mjekut tuaj, që të modifikoj trajtimin tuaj.

-Obeziteti (dhjamosja)-Sipas studimeve më të fundit, indi dhjamosja do jete një organ imunitar- mbrojtës, që mund të frenoj direkt funksionin imunitar metabolik. Një ndjekje personave me grip gjate 3 sesioneve complete, rezultatet e të cilave kane qene publikuar në 2018, lejoi të konstatohet se eliminimi i virusit ishte më i ngadalshëm tek 42% e adultve obez (dhjamosur) se sa në ato me peshe normale. -Diabeti-personat me glicemi të larte në gjak janë një faktor inflamator, që frenon sistemin imunitar dhe rëndon rrezikun e infeksionit, të prekshëm janë dhe personat që nuk masin, ose nuk shënojnë matjet e glicemis (neglizhentet). -Kanceri, qofte vete dhe trajtimet e tij ulin leukocitet dhe frenon imunitetin, favorizon infektimin, pra janë më të dobët. Pra, duhet të mbahen në vëzhgim.-Astma dhe sëmundjet e mushkërive-viruset kane preference të veçantë për të goditur (prekur) mushkëritë, kështu personat që vuajnë nga aparati respirator goditen më rende dhe sëmundjet e zemrës e ato që rrisin tensionin e gjakut (HTA) dhe turbullimet të tjera, rrisin mundësinë e infeksionit tek të moshuarit, llogaritet se 40% e të sëmureve me Covid-19 të shtruar në spital vuanin nga një sëmundje cardio-vaskulare-

Sëmundjet autoimmune në njërin ane dhe një infeksion mund të shpërthej, atak të Artritit Reumatoid, skleroza me pllaka (multiple), ose psoriaza etj. ndërkohë, që këto sëmundje janë trajtuar me immunosupresor, të cilat rrisin rrezikun për infeksion. Sëmundjet autoimmune, mund të shkaktojnë sëmundje intersticiale (pneumoni) si fibroze pulmonare kërcënues për jetën e pacienteve.

Përgatiti Dr. med. Ndue NIKAJ
Patolog-Internist

Frederik Ndoci

- Vëllimi III me poezi, pjesa e parë -

Frederik Reshpja-s

Sikur mos te ishte aq i madh
sa te mos e vinim re
kur kalonte rrugëve,
nuk do ta zinte brenda
qelia aq e vogël,

dhe Gethen kojshi
dera derës po ta kisha,
do me dukesh bejtaxhi
qe m' zuni dëshirën,
për ti lexue
vargjet e adashit Reshpja,
ne te rijt e fishkun tem.

E sot m'i lexoi
ngrica e New Yorkut
vargjet e tij,
E n' Ftyre
m'shkundi boren
dege e perlotun.

Sot ky ghost Frederik
Me shfaqet ne çdo zog
Qe ne peme ndalet
E këndon kangen e tij.

Ciceron
e me buzqesh me ironi,
"me kishe pran si mësues,-
me thot
-kur kendoje qysh femij"

"Atehere ndoshta
s'me mori kush per njeri,
se tingullin violincelit
e mesova
prej deres se burgut,
qe hapej sa mbydhej,
per mu,

Ishin hyrje dalje
Me pranga pa ceremoni
ishte e vetmja melodi,

Nen rythm shkopijs gome.
nga qe flija,
me pupla hekuri lidhur
Kamb e duar!
ne shtratin e antikonformizmit."

"Un deshta lirin e nanen,
Bardh e zin e bores
Edhe paqen e hanen,
Rrullat e pellembes se dores
Nga mundi i shperbamjes

Perendive e Zotit,
me shplake ia mbylla syt,
qe mos te verboheshin
nga shpirtat e ndjete."

Me tha edhe diçka ne vesh:
- "O Rrik, urrej ata qe me lexojnë
vetem nji her ne vit,
kur si zarf mund te me ken
ne çdo xhep,
per dit..."

...qe femijeve tia spjegosh
se çfar don me than
"kem hjek keq",
i kalbun kam jetu vetem 57 vjet,

Un kurr s'gabova me jeten
Pse dishrojshe
me than te verteten

Ah sa gaboi jeta me mu,
qe tu jepsha me kuptu
Ne se prej frikes at' here
krejt zemra ju pat l'shú

Brohorimave nuk tu mbaru
Sot prap kjo fraz vlen per ju
"mos u gezo o i gezuem
e mos u hillno o i hillnuem"

17 shkurt 2020

Nji poezi satirike

Personale e gjithmon aktuale

Del A. Moisiu ne R.Mejdan
provon B.Topin per B.Nishan
Thot R.Alia mos S.Berish,
Planet smundesh me mi prish
I.Meta hijeve avash avash,
Mos kujtoni se jam dash?
"Mi thuej ketyne ore rriik,
Se sjam dash me m'ba ferlik
I kam rranjet thell thell
Se kan leht me me fut ne hell
Jam I ndershem -1000 pash!
Jemi ne qe e kemi trash!
Nuk asht thjesht veç pun grash!"

T'gjith po shohin se ça ban frika!
Hiç spo ndihet amerika?
N'ket rrumuj kaçurrell!
ErLulEdi pro turkish telenovel,
3 pik-sh kosh-at me tabel.
Tan kan marr nga 5 "personal"
Se lshojn fushen pa skandal!
Kartel t'kuqe hiq se njohin,
Deri sa tan populli, t'cofin.

U ul ndej prap n'jai Lul Pasha,
E po pyet" si jeni vasha"
Spo i rruen hiç ata vetlla trasha,
Rama shkurt i thot:
O LuBa mos se deti su ba kos?!
Se t'padis te baba Soros,
Ka urdhnu qe te mbretnoj gjat,
E Mos I hyr pyllit pa spat!

Ban sikur te ka mbet hatri
Mi hiq sonte militantat nga teatri
Ta mbarojm ket pun me nder
Je i paguem si gjithher
Me deshtu si shofer.
Se ka fillu me t'ardh ere
E Sa ta marrin vesh bagtia
Se veç monizem ka Shqipnia
Si dole prej çadre e mbetem miq!
Shko te Erioni, e ha do fiq!
Hin e ske nevoj me trokit ne der
Te bajm ç'thot xhaxhi enver.
kena Soros te gjith trainer,
Her trainer e her shofer,
Them tja hellim edhe kesaj her!
Fshihu Nano atje ku je,
Se spo merret kush me ne!
Ska me ardh askush me t'pre
E bajm jeten lum si ne
Prit veç pak, se atje na ke.
Te vertetat ndhé me i fsheh
Tan per ne hala bajn be.

Poezi me rastin e 6 deshtimor te LuBa-s
(Kjo asht nji nder kangt e mia personale,
qe e gjeni ne you tube me titullin e saj)

Mekat me u m'plak' larg teje!

Malli buron prej Bun's,
buz kalase, ku nis magjia.
kang jare i fali rrug's,
Shkodran-she kur m'belbzon femija.

Ky mall ma i madh se malet,
e qe kalb ne lot cdo ftyre,
m'gjej Shkodran qe s'ndalet.
Kur Rozafa n'shpirt e kqyr.

Oh zani i jem qe fle' te liqeni,
Ku prarojne vec yje e Han.
N'valzat e argjenda,
sa shum varza syte kan lan.

ah sa mall fle te Liqeni,
Ku prarojne vec yje e Hane.
Valezat e argjenda,
mbrena sa premttime mbajne.

Kjo kang, dhurate prej meje,
ku kputa lulen e par
kur m'dogj si flake rrfeje,
aj syni yt rreze ar.

cdo kang dhurat prej meje,
Per ty o sofer nane,
asht' mekat me u m'plak larg teje,
Jareja Shkodrane...

2012 maj



Afforizma nën muzë vargjesh

Diell

Rrezen e Diellit
ma shum e shijon ndit dimri
Kurr ftohjen s'ta hjek
Por prap rrim ne diell
edhe pse e dim
se heret a von t'djeg

Detin

dikush edhe mund ta blej!
Por dallget sia ndalon.
Tan krypa e tij,
ne miljona jet qe mori
e mban ndry por..
ska ma shum hillsim
se loti qe del nder sy

Hana

hena gjys muaji
shtigjet ti kallxon
E gjysa tjetër
romantikave te shtegton
Shpesh nga dritare e vetmise,
Sheh nalt nga hana.
vjen si gozhde kryqezimi
E te kujtohet diku larg-Nana.

Miresia

kur ta japin
kurr nuk thue :
-boll se me tepron,
Jepe pak dhe ti
se asgja dam nuk t'shkon.

Durimi

kur zemren
Nji hall i madh te ndalon!
E prap durimi prap tan durim
E ven ne pun zemren
Fillon e shkreta, rreh e punon,
Me durim e ia hjek tan heshtat
Qe djajt ta kan shpu
E prap me durim "fal e harron"

Mirnjohja

asht gjithshka
Le te bahet prá ves
Qe gjithkush e meriton
N'se dikush nji t'mir t'ka ba
E Kur nuk ia harron
Asht mirnjohje e Tij
qe e ke pa prá
Asht n'jai Zot
qe asnji her s't'leshon.

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
Av. ANTON KOSTERI

